



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 21 (827876)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 24 maj 2024

Certifikohen pjesëmarrësit e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në Takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel shef shtabi, në selinë e NATO-s, Bruksel, Belgjikë.

Takimi u drejtua nga kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admirali Bauer, me mbështetjen e komandantit Suprem të Aleancës për Operacionet, gjeneral Cavoli, si dhe komandantit Suprem të Aleancës për Transformim, gjeneral Lavigne.

Në hapjen e punimeve të takimit ishte i pranishëm edhe sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i cili në fjalën e tij theksoi kënaqësinë që i jepte prezencën në këtë forum dhe mundësia për të paraqitur përditësimet politike dhe të dëgjojë perspektivën e shefave të shtabit të Aleancës në planet për të ardhmen.

Gjatë punimeve të këtij takimi, përfaqësuesit e lartë ushtarakë diskutuan mbi një sërë temash, të cilat kishin për qëllim vlerësimin e arritjeve të deritanishme dhe objektivat drejt dhe përtej Samitit të Uashingtonit, që do të mbahet në muajin korrik të këtij viti.

Në sesionin e parë të takimit, të drejtuar nga gjeneral Lavigne, u bë një përditësim mbi përpjekjet e Aleancës në kuadër të transformimit dhe agjenda e zhvillimit teknologjik të Aleancës. Sesioni i dytë i këtij takimi i ishte dedikuar Këshillit NATO-Ukrainë. Gjatë këtij sesioni, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Ukrainës, gjeneralmajor Barhylevych, pasi ofroi një përditësim operacional të situatës në Ukrainë, vlerësoi mbështetjen e gjithanshme të vendeve të Aleancës, si dhe u ndal në nevojat urgjente me të cilat Forcat e Armatosura të Ukrainës po përballen.

Në fjalën e tij gjatë këtij sesioni, SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, vlerësoi heroizmin e Forcave të Armatosura dhe popullit ukrainas në luftën për mbrojtjen ndaj agresionit rus, si dhe mbështetjen e ofruar nga vendi ynë me trajnim, armatim, municione dhe automjete për forcat ukrainase: “Donacioni ynë i radhës është në proces, krahas një helikopteri MI-8 dhe 12 mjeteve të blinduara, që sapo janë dërguar. Në ditët në vijim do të dërgojmë disa tonë municione të kalibrave të

SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji: Krahas një helikopteri MI-8 dhe 12 mjeteve të blinduara, disa tonë municione të kalibrave të ndryshëm, do të nisen drejt Ukrainës



ndryshëm”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji.

Në vijim të fjalës së tij, gjeneralmajor Kingji theksoi gjithashtu dhe vullnetin e vendit tonë për t’iu bashkuar Koalicionit të Çlirimit të udhëhequr nga Lituania, për të trajnuar personelin ukrainas

në fushën e EOD, dhe rolin e Këshillit NATO-Ukrainë në avancimin e procesit të anëtarësimit të Ukrainës në NATO.

Sesioni i tretë i takimit iu dedikua progresit të bërë drejt zbatimit dhe ekzekutimit të Familjes së Planeve të DDA, që u miratua në Samitin e Vilnius

në korrik 2023. Në fjalën e tij përgjatë këtij sesioni, gjeneralmajor Kingji vlerësoi rolin e planeve rajonale në forcimin e aftësisë shkurajuese dhe mbrojtëse të Aleancës, si dhe ofroi një panoramë të masave të marra nga vendi ynë në drejtim të zbatueshmërisë dhe mbështetjes së këtyre planeve.

Përfundoi Kursi i Avancuar i Oficerit në specialitetin Polici Ushtarake

Në mjediset e Garnizonit Vaqarr, u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit të Avancuar të Oficerit, në specialitetin Polici Ushtarake. Në këtë aktivitet mori pjesë nënkolonel Artur Loka dhe pjesëtarë të shtabit të Policisë Ushtarake.

Fjalën e rastit në këtë ceremoni e mbajti zëvendëskomandanti i Policisë Ushtarake, i cili në fjalën e tij shprehu falënderim të veçantë për Seksionin e Stërvitjes për punën e pa lodhur dhe përkushtimin e tyre në përgatitjen e efektivave të Policisë Ushtarake, të cilët merrnin pjesë në Kursin e Avancuar të Oficerit.

Në përfundim të fjalës së rastit efektivët u pajisën me certifikatën përkatëse.

Ky kurs ka për qëllim marrjen e njohurive themelore mbi veprimtarinë, karakteristikat dhe mënyrat e organizimit dhe drejtimit për të gjitha detyrat dhe operacionet që kryen Policia Ushtarake në kohë paqeje, krize dhe lufte si dhe për t’i zbatuar ato në përmbushje të detyrës në nivel toge, kompanie dhe specialisti, në shtabin e Policisë Ushtarake.



Policia Ushtarake pajiset me mjete të blinduara tip “Iveco Lince”

Policia Ushtarake pajiset me mjete të blinduara tip “Iveco Lince”. Këto pajisje kërkojnë edhe njohuri për drejtimin dhe mirëmbajtjen e tyre dhe për këtë arsye efektivët e Policisë Ushtarake u trajnuan nga kolegët e tyre të Karabinierisë Italiane, jo vetëm për drejtimin e këtyre mjeteve të rënda në terrene të vështira, por mbi të gjitha, duke simuluar defekte gjatë operacioneve.





Certifikohen pjesëmarrësit e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen

Në mjediset e auditoriumit “Gjeneral Enrico Tellini”, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, nën kujdesin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, u organizua ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve të Kursit të 14-të, të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen.

Në këtë aktivitet, me rëndësi për Kolegjin dhe jo vetëm, morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, ambasadorë dhe atashe ushtarakë rezidentë në vendin tonë, anëtarë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare dhe deputetë të Parlamentit Shqiptar, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, znj. Gelardina Prodani, komandantë forcash kryesore dhe të njësisë autonome, familjarë, drejtorë dhe përfaqësues të lartë nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA-së.

Në fjalën e tij të mirëseardhjes, komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj falënderoi institucionet e larta të vendit dhe Forcat e Armatosura të vendeve të NATO-s dhe më gjerë, për pjesëmarrësit e dërguar, duke vlerësuar për studimet e tyre, institucionin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë ndër të tjerë. Më pas ai u ndal në trajtimin e çështjeve kryesore gjatë kursit, ku kombinimi i duhur i përfaqësuesve bëri që jo vetëm të diskutoheshin tema aktuale të mjedisit të përbashkët të mbrojtjes dhe sigurisë, por dhe të shkëmbeheshin opinione dhe mendime, duke krijuar një ‘network’ të qëndrueshëm në kohezion me situatën aktuale të sigurisë. Një falënderim të veçantë adresoi për pjesëmarrësit nga Bullgaria, Gjeorgjia, Gjermania, Italia, Kosova, Rumania, Greqia dhe Turqia, të cilët sollën frymën e bashkëpunimit të ndërsjelltë me punën dhe përfaqësimin e tyre përgjatë tre muajve. Në përfundim komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA-së për mbështetjen e dhënë në vijimësi për realizimin me sukses të kursit.

Në përfundim të tij në emër të kursit, kolonel Silviu-Vasile Maricas citoi: “Më lejoni që në fjalën time së pari të falënderoj Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe nëpërmjet tij edhe shtetin shqiptar për mikpritjen, mbështetjen dhe qasjen mjaft pozitive ndaj të gjithë anëtarëve të kursit, që tashmë do jetë një eksperiencë e paharruar profesionale dhe kulturore. Kurrikula e pasur me tema aktuale



nga mjedisi rajonal dhe botëror, pjesëmarrja e përfaqësuesve të lartë nga institucione prestigjioze dhe me emër, por dhe ekspertëve të çështjeve civile dhe ushtarake nga Shqipëria, SHBA-të dhe Evropa, e bënë këtë kurs tërheqës dhe frutdhënës, duke kontribuar në zhvillimin profesional dhe arritjen e objektivave të trajnimit. Udhëtimet studimore brenda dhe jashtë vendit na lejuan të njohim nga afër infrastrukturën dhe organizimin e mekanizmave të sigurisë por dhe të njohim më shumë qasjen e lidershit politik dhe ushtarak në çështje të ndryshme. Përvojat e ndryshme akademike dhe profesionale sfiduan aftësitë tona të komunikimit dhe punës në grup, duke nxitur mirëkuptimin e përbashkët. Gjatë tre muajve, ne kuptuam se ndajmë interesa dhe shqetësime të përbashkëta për sigurinë në rajon dhe më gjerë. Faleminderit!”. Në fjalën e tij të rastit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, pasi uroi pjesëmarrësit e kursit për përfundimin me sukses të Kursit të 14-të të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, vlerësoi kontributin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë për drejtimin dhe zhvillimin e kursit më të lartë në piramidën e arsimit ushtarak për çështjet e Sigurisë dhe



Mbrojtjes. “Kënaqësi të marr pjesë sot në këtë ceremoni të veçantë. Në emër të Ministrit të Mbrojtjes dhe në emrin tim ju uroj për këtë arritje në karrierën tuaj, kursi që sapo përfunduar ka një rëndësi duke konsideruar mjedisin e sigurisë rajonal dhe botëror, në këtë mjedis të ri Aleanca është më e fortë se kurrë, me 32 shtete e ndërtuar mbi principet e demokracisë dhe ligjit. Kursi që sapo përfunduar ka kontribuar në aftësitë tuaja për të vepruar me çështje kritike, në rritjen e

njohurive dhe në ndërtimin e një ‘network’ që do t’ju vlejë padyshim në të ardhmen. Urime!”, - përfundoi fjalën e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji. Në këtë kurs morën pjesë 15 përfaqësues nga Forcat e Armatosura Shqiptare, institucionet e sigurisë në vend si dhe përfaqësues të ushtrive të vendeve të NATO-s dhe partnere. Aktiviteti u mbyll me shpërndarjen e certifikatave dhe me fotografi të përbashkët.

Stërvitje e përbashkët mes studentëve të vitit II në Shkenca Ushtarake të FMS-së dhe Gardës Kombëtare të Nju Xhersit

Garda Kombëtare e Nju Xhersit, përmes Programit të Partneritetit Shtetëror me 20 kandidatë oficerë nga shkollat e kandidatëve për oficerët e Gardës Kombëtare të Ushtrisë së Nju Xhersit dhe të Nju Jorkut, u bashkuan studentëve të vitit të dytë në Shkenca Ushtarake të FMS-së nga Akademia e Forcave të Armatosura. Gjatë kësaj periudhe u praktikuan procedurat e drejtimit të trupave. Grupet zhvilluan një trajnim për kalimin e ujit me trajnerët dhe stafin mbështetës përkatës. Kandidatët për oficerë dhe kadetët rishikuan teknikat e kalimit të lumit, procedurat e sigurisë dhe përdorimin praktik të litarit gjatë trajnimit. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe vëzhgues nga Ushtria e Maqedonisë së Veriut dhe pjesëtarë nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Kjo stërvitje përfshiu trajnime për leadershipin, ushtrime trajnimi për situatën, shkëmbime kulturore dhe stërvitje fizike. Viti 2024 shënon gjithashtu vitin e tretë të këtij programi të përbashkët trajnimit të oficerëve.



Vendi ynë është pjesë e Organizatës Ndërkombëtare për Ndhimat në Lundrim – The International Association of Marine Aids to Navigation and Lighthouse Authorities (IALA), prej vitit 2022, në zbatim të ligjit nr. 68/2022 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Ndhimat në Lundrim”.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar disa aktivitete të përbashkëta, të cilat kanë shërbyer për vlerësimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve të vendit tonë nga ekspertët e IALA-s, për të përcaktuar nevojat për përmirësim në fushën e sinjalistikës detare dhe dhënien e ndihmës për lundrim. Në këtë kuadër, Komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare kundëradmiral Adnand Agastra dhe Komandanti i Shërbimit Hidrografik kapiten i rangut II Artan Malo, pritën delegacionin e Organizatës Ndërkombëtare të Ndhimës në Lundrim (IALA).

Delegacioni kryesohej nga Sekretari i Përgjithshëm i “IALA”, z. Francis Zachariae dhe shoqërohej nga dy ekspertë të Autoritetit Detar të Danimarkës (ADD), z. Jorgen Royal Petersen dhe znj. Ulla Bjorndal Moller.

Gjatë vizitës së tij në Shqipëri, z. Francis Zachariae pati takim dhe me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, i cili vlerësoi angazhimin e Tij në projektin për modernizimin e sinjalistikës lundimore në ujërat territoriale të RSH.

Qëllimi i kësaj vizite ishte përcaktimi i nevojave që ka FD/RB, në fushën e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve dhe sistemeve të sinjalistikës detare. Fokusi kryesor, përqendrohej rreth një projekti për ndërtimin e kapaciteteve, që synon rritjen e aftësive të Republikës së Shqipërisë në fushën e shërbimeve të Ndhimës Detare në Navigacion (AtoN – Aids to Navigation), me mbështetjen nga Autoriteti Detar Danez dhe IALA. Autoriteti Detar Danez ofroi mbështetjen

Vizitë zyrtare e Sekretarit të Përgjithshëm të IALA dhe përfaqësuesve të Autoritetit Detar Danez



me ekspertë në fushën e ndërtimit të kapaciteteve në fushën e sinjalistikës detare dhe dhënien e ndihmës për lundrim, si dhe në bashkëpunim me Akademinë e IALA-s (IALA World-Wide Academy), do të ofrojë shërbime për personelin e Shërbimit Hidrografik të FD/RB.

Projekti i parashikuar, do të ndihmojë në modernizimin dhe zhvillimin e SHH të FD/RB dhe kapaciteteve të tij për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare, duke rritur sigurinë lundimore në rajon. Projekti i ngritjes së kapaciteteve të SHH, me ndihmën e Autoritetit Detar Danez dhe IALA, qëndron si një mundësi unike dhe e vlefshme për Republikën e Shqipërisë. Ai jo vetëm që përputhet me standardet ndërkombëtare, por gjithashtu premtan të forcojë sigurinë dhe ndikimin detar në rajon.

Ekipi i ekspertëve të Kompanisë EOD përfundon operacionin në Labinot - Fushë, Elbasan

Një tjetër operacion është përmbyllur me sukses nga specialistët e kompanisë EOD të batalionit të xhenios, në Njësinë Administrative Labinot-Fushë, bashkia Elbasan.

Pas informacionit dhe kërkesës për ndihmë të marrë në mënyrë operative, një grup ekspertësh kanë shkuar pranë vendit të banuar, ku ishte pikasur një municion luftarak i rrezikshëm. Me anë të vlerësimit të kujdesshëm dhe duke zbatuar të gjitha rregullat që parashikon manuali EOD, grupi i ekspertëve konkludoi se municioni i gjetur, “predhë topi eksploziv thërrmuese”, ishte i lëvizshëm, duke bërë dhe magazinimin në ambientet e batalionit të xhenios.



Kursi i Lartë i Oficerit zhvillon vizitë mësimore në Komandën e Forcës së Bashkuar të NATO-s, Napoli, Itali

Grupi mësimor i kursit të Lartë të Oficerit (KLO) nën koordinimin e Departamentit të Operacioneve Ushtarake, vizitoi Komandën e Forcës së Bashkuar të NATO-s, Napoli, Itali.

Gjatë vizitës akademike kursantët u njohën nga stafi i Komandës së Bashkuar të NATO-s (JFC) me misionin, rolin, detyrat dhe angazhimet kryesore të kësaj komande.

Gjatë takimit, pjesëmarrësit diskutuan ndër të tjera dhe mbi çështje që lidhen me implementimin e koncepteve të Aleancës për modelin e ri të Forcave dhe integrimin e planeve rajonale të NATO-s me planet kombëtare të vendeve anëtare. Në fokus të prezantimeve ishin dhe adresimi i sfidave dhe kërcënimeve të reja në rajon, ku koncepti i shkurajimit dhe mbrojtjes së zonës Euro-Atlantike në 360 gradë të saj, do të jetë themeli i përgatitjes së forcës.

Përfundoi me sukses Kursi i Avancuar i Nënoficerit të Forcës Ajrore

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore, Kuçovë, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të Avancuar të Nënoficerit, në specialitetin Forcë Ajrore.

Në këtë ceremoni mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Luan Sadiku, i cili theksoi rëndësinë e trupës së nënoficerit për të gjitha specialitetet që shërbejnë në Forcë Ajrore. Arsimiti, kualifikimi dhe trajnimi i personelit është element thelbësor që shërben si bazë solide për krijimin e një trupe profesionale për t'iu përgjigjur kërkesave dhe sfidave në rritje në një mjedis sfidues sigurie.

Gjatë kësaj periudhe kursantët kanë marrë njohuritë e duhura teorike dhe praktike në specialitetin e Forcës Ajrore, duke u rritur profesionalisht në realizimin e detyrave.

Ky kurs shërben për forcimin e elementëve të lidërshiptit të trupës së nënoficerit, por edhe për rritjen e kohezionit të elementëve të ndryshëm teknikë e profesional që shërbejnë në Forcën Ajrore.



Forca Ajrore, pjesë e stërvitjes ndërkombëtare të përbashkët "Anatolian Phoenix-24" në Turqi

Stërvitja Ndërkombëtare "Anatolian Phoenix-2024" është një stërvitje, e cila u zhvillua në Komandën III, të bazës kryesore "Jet" në Konya, Turqi.

Në kuadër të kësaj stërvitjeje, Forca Ajrore mori pjesë me personel pilot si dhe nga QKR, krahas vendeve pjesëmarrëse si Turqi, Azerbajxhan, Arabia Saudite, Sllovakia, Romania, Polonia, Katari. Pjesëmarrja është në kuadër të monitorimeve të procedurave, planëzimit të fluturimeve në operacionet luftarake CSAR, SAR, CASEVAC, MEDEVAC, CAS, EW, JTAC.

Stërvitja synoi të testojë dhe përmirësojë proceset e komandimit dhe kontrollit brenda kornizës së operacionit të Rimëkëmbjes së Personelit (PR), rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet elementeve të Task Forcës, në mjediset luftarake dhe me vendet e tjera, si dhe identifikimin e fushave të bashkëpunimit. Kjo stërvitje u finalizua me DVD, ku mori pjesë dhe komandanti i Forcës Ajrore shqiptare, gjeneral brigade Ferdinand Dimo.

Demonstrimet e përbashkëta përfshinin ushtrime stërvitore të kryera me helikopterë të tipit "Skorsky" nën komandën e Forcave Ajrore, hedhje me parashutë nga aeroplanë mallrash CN-235, si dhe stërvitje për rikuperimin e personelit në ujë të kryera me helikopterë të tipit "Cougar".



U zhvillua ceremonia për përfundimin e Kursit të Parë të Kërkim – Shpëtimit nga zjarri

Në ambientet e Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile, u zhvillua kursi i "Kërkim-Shpëtimit nga Zjarri", ku morën pjesë 20 kursantë, efektivë të këtij reparti.

Në përfundim të këtij kursi, në ambientet e Qendrës Stërvitore, u zhvillua ceremonia për certifikimin e efektivëve pjesëmarrës.

Në këtë ceremoni morën pjesë zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla, komandanti i BMEC-së, kolonel Hajdar Gurra dhe të ftuar të tjerë.

Komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla, në fjalën e tij përshëndetëse përpos falënderimeve për përkushtimin dhe entuziazmin e kursantëve pjesëmarrës për të fituar sa më shumë njohuri, e vuri theksin te rëndësia që ka zhvillimi i kurseve të tilla profesionale, për të mbështetur struktura me mision të veçantë, sikurse është kompania e kërkim-shpëtimit, me personel profesional. Kursantët me anë të programit të konceptuar në përgatitje teorike dhe praktike, u pajisën me aftësitë dhe ekspertizën e duhur për të kryer operacione kërkim-shpëtimi ndaj zjarrit në ambiente të mbyllura dhe të hapura, evakuim deri në vënie në kontroll të situatave që krijohen nga zjarri. Zhvillimi i kurseve profesionale do të ketë vëmendje të shtuar nga Komanda Mbështetëse, për vetë misionin e rëndësishëm dhe human që kryejnë këto struktura në përballimin e emergjencave civile.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Familja është njësia bazë grupore e shoqërisë dhe i jepet mbrojtje nga shoqëria dhe nga shteti”

Shpesh e përcaktojnë si një grup që karakterizohet nga mendimi praktik, bashkëpunimi ekonomik dhe riprodhimi. Sidoqoftë, familja është grupi natyral dhe kryesor në shoqëri, që ka të drejtë mbrojtjeje nga shteti e shoqëria. Aty përfshihen marrëdhënie të bashkëjetesës së çiftit dhe të fëmijëve, apo të adoptuarve dhe mbiemri (jo domosdoshmërisht). Në familje fillon dhe formohet personaliteti njerëzor.

Unë jam lindur dhe rritur në një familje ku qendra e vëmendjes ishin mami dhe babi, njerëzit që na mësuin se si të ecim në jetë me moral dhe dinjitet. Por sot me globalizimin po përballemi dhe me “lloje” të tjera organizimesh të jetëve humane, në ato që “familjen po e etiketojnë prindi 1 dhe 2”, duke humbur kështu vlerën e jetës, emrin e bukur nënë dhe dashurinë sublime babë.

Në librat e shenjtë të religjioneve të ndryshme është një deklaratë madhështore për misterin e martesës: Atëherë, Zoti Perëndi e futi në një gjumë të thellë burrin, të cilin e zuri gjumi; dhe mori një nga brinjët e tij dhe e mbylli mishin në atë vend. Pastaj Zoti Perëndi me brinjën që i kishte hequr burrit formoi një grua dhe e çoi te njeriu. Dhe njeriu tha: “Kjo së fundi është kocka e kockave të mia dhe mishi i mishit tim. Ajo do të quhet grua sepse është nxjerrë nga burri”. Për këtë arsye njeriu do të braktisë babanë dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij, dhe do të jenë një mish i vetëm.

Perëndia gjithmonë do të vazhdojë të bekojë institucionin e martesës midis një burri dhe një gruaje. Çdo përpjekje tjetër është vetëm një kopje e lirë dhe një imitim i shëmtuar i asaj që Krijuesi e ka bërë të jetë dhe të mbetet e bukur.

Kohët e fundit po flitet për një ligj që i jep të drejtën dy njerëzve të së njëjtës gjini të martohen dhe të krijojnë ‘familjen e tyre’, ky ligj do të sillte probleme të mëdha në lidhje me identitetin në realitetin shqiptar. Politikanë të ndryshëm, analistë dhe njerëz të nderuar të medias kanë konstatuar, në kohë të ndryshme, që vendi ynë ka kaluar përmes krizave të mëdha. Dikush mund të thotë që sot vendi ndodhet në një krizë aspak të vogël. Nga vëzhgimi im kam arritur në përfundimin, që vendi ynë përpara se të jetë në një krizë politike, përpara se të jetë në një krizë ekonomike, përpara se të jetë në një krizë korrupsioni, është në krizë të identitetit. Përgjatë historisë së shkurtër të shtet formimit shqiptar ne mund ta shikojmë këtë argument të jetë i vërtetë.

**Çfarë po ndodh me identitetin e individit dhe familjes?
A gëzon individ dhe familja në vendin tonë një identitet më të konsoliduar sesa kombi ynë?**

Nuk ka tmerr më të madh për dikë sesa të mos njohë identitetin e tij, pra të mos dijë se kush është? Homoseksuali është shtegtari i planetit që ka humbur rrugën, pasi më parë ka humbur identitetin e tij. Etiketa që mund t’i shkonte më shumë një personi me këto devijime është ajo që mban të shkruar pyetjen: “Kush jam unë?”, “A jam një burrë apo një grua?”. Por edhe në përpjekjen më të madhe të njeriut për të njohur veten, ai është përballur me anën më të errët të tij.

Cila është gjendja e familjes në vendin tonë?
Vetëm në vitin e fundit në vend regjistroheshin 6,400 divorce. Sa është numri i fëmijëve që do të rriten vetëm nga njëri prej prindërve si pasojë e këtij numri divorcesh?

Kjo është e keqja më e vogël, sepse në fund të ditës këta fëmijë do të kenë të paktën njërin nga prindërit që do t’i

A ka diçka që mund të ndalojë të ashtuquajturat “Të Drejta Të Njeriut?”



mbulojë me batanije dhe do t’i dhurojë puthjen e natën e mirë. Tani në këtë tablo të dhimbshme mendoni të fusni dhe diçka krejtësisht ndryshe dhe akoma më të shëmtuar në realitetin e familjes shqiptare.

Implikimet tek fëmijët në një botë ku familja po kalbet çdo ditë, janë shumë të thella. Në një nga artikujt e fundit të të përjavshmes amerikane “STANDARD” përshkruhet se si ‘sanksionimi ligjor i bashkimit të personave të së njëjtë seks ka shkatërruar institucionin e martesës në vendet skandinave, ku gjysma e fëmijëve të sotëm lindin jashtë martese. Që nga kjo pikë e tutje, gjykatat nuk do të jenë në gjendje më të favorizojnë familjen tradicionale, e cila përfshin një burrë dhe një grua në krahasim me një çift homoseksual për sa i përket adoptimit të fëmijëve. Fëmijët jetimë do të vendosen në shtëpi me prindër, që prezantojnë të njëjtin seks mbi parime të njëjta, siç do të adoptohej nga një mami dhe një babi. Në perspektivën e fëmijëve jetimë nuk do të ketë të drejtë për të zgjedhur, pasi ligji i njeh këtë të drejtë njëlloj çifteve të të njëjtit seks. Në vend që të sigurohet një nënë dhe një baba, martesat e ardhshme të homoseksualëve do të prodhojnë miliona fëmijë pa baba dhe miliona fëmijë pa nëna. Sociologët e sotëm në mënyrë të vazhdueshme kanë këmbëngulur në paralajmërimin e kësaj çarje të madhe të familjes. Nëse kjo do të ndodhë,

theksojnë ata, atëherë pothuajse çdo fëmijë do të ketë disa nëna dhe disa baballarë, dhe ndoshta gjashtë deri tetë gjyshër ose gjyshe dhe dyzina me gjysmë-vëllezër dhe gjysmë-motra. Do të jetë një botë ku djem dhe vajza të vogla do të tërhiqen dhunshëm nga kolona e familjes, për t’u postuar prej modeleve të ndryshueshme të mënyrës së jetesës, ku shumë prej tyre do të rriten në familje adoptuese ose streha e tyre do të behet rruga (siç miliona fëmijë po bëjnë tashmë në vende të tjera nëpër botë.)

A do të na çonin martesat homoseksuale në poligami?

Legalizimi i martesave brenda së njëjtës gjini do të udhëheqë në mënyrë të padiskutueshme në poligami dhe në alternativa të tjera të bashkimi të burrave dhe grave.

Pse do të na çonin martesat homoseksuale në poligami?
Sepse nuk ka asnjë ndalesë tjetër nëse sakrilegji i martesës do të shkelet. Historikisht, përcaktimi i martesës është prehur në themelin e traditës, në përparësinë ligjore, në teologji dhe në mbështetjen e pakapërcyeshme të njerëzve. *Çfarë do të thoshim atëherë për martesat në grup, ose për martesat mes kushërinjve, ose për martesat mes të rriturve dhe fëmijëve? Po për martesën mes njeriut dhe një kafshe?*

A ka diçka që mund të ndalojë të ashtuquajturat “Të Drejta Të Njeriut?”

Mediat botërore: Shqipëria, perla natyrore, destinacioni i 2024

Shqipëria, një perlë e fshehur e Ballkanit, është një tokë e kontrasteve magjepsëse, ku e lashta takohet me modernen dhe natyra e egër bashkëjeton me jetën e gjallë urbane. Ky vend, i pasur me histori dhe kulturë, ofron një shumëllojshmëri qytetesh unike, secili me karakterin dhe kuptimin e vet. Në këtë artikull, eksploroheh qytetet më të bukura dhe më të rëndësishme në Shqipëri, duke ofruar një vështrim të thellë se çfarë e bën secilin prej tyre të veçantë.

Tirana

Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë, është zemra e vendit që rreh. E themeluar në vitin 1614, është një qytet i ri në krahasim me kryeqytetet e tjera evropiane, por kjo nuk e pengon atë të ketë një histori të pasur dhe kulturë të gjallë. Qyteti është i njohur për arkitekturën e tij eklektike që përziën ndikimet osmane, fashiste dhe komuniste, duke pasqyruar periudha të ndryshme historike që ka kaluar.

Sheshi Skënderbej është qendra nervore e Tiranës, i rrethuar nga ndërtesa emblematike si Xhamia e Et'hem Beut, Muzeu Historik Kombëtar dhe Kulla e Sahatit. Vitet e fundit, Tirana ka pësuar një transformim të rëndësishëm urban nën qeverisjen aktuale, duke u kthyer në një model moderniteti dhe inovacioni urban në Ballkan. Qyteti ofron gjithashtu një skenë të gjallë kulturore me teatro të shumtë, galeri arti dhe festivale që gjallërojnë jetën e ditës dhe të natës.

Berati

Berati, i njohur si “Qyteti i një mbi një dritareve”, është një nga qytetet më të vjetra dhe më të ruajtura në Shqipëri. I vendosur në jug të vendit, përgjatë brigjeve të lumit Osum, Berati është një shembull i jashtëzakonshëm i një qyteti osman të ruajtur mirë. Ai u shpall një sit i Trashëgimisë Botërore nga UNESCO në 2008.

Qyteti është i famshëm për shtëpitë e tij të bardha shumëkatëshe që duket se ngjiten në kodër, duke krijuar një panoramë që të lë pa frymë. Kalaja e Beratit, ende e banuar, ofron pamje spektakolare të qytetit dhe rrethinave të tij. Brenda mureve të saj gjenden kisha të shumta bizantine dhe xhami osmane, që dëshmojnë për bashkëjetesën paqësore të feve të ndryshme ndër shekuj. Berati është gjithashtu një qendër e prodhimit të verës, duke e bërë atë një destinacion ideal për dashamirët e verës.

Gjirokastrë

Gjirokastra, gjithashtu një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, shpesh quhet “Qyteti i Gurit” për shkak të shtëpive të tij karakteristike prej guri me çati prej rrasash. I vendosur në rajonin malor të Shqipërisë së Jugut, ky qytet është i famshëm për arkitekturën e tij osmane të ruajtur mirë dhe si vendlindja e shkrimtarit të famshëm Ismail Kadare.

Kalaja e Gjirokastrës dominon qytetin nga maja e një kodre dhe strehon një muze ushtarak interesant dhe një burg të vjetër. Duke ecur nëpër rrugët me kalldrëm të qytetit të vjetër, mund të admironi mjeshtërinë e shtëpive të lashta dhe të vizitoni pazarin, ku mund të gjeni produkte artizanale vendase. Gjirokastra është gjithashtu shtëpia e Festivalit Kombëtar Folklorik, i cili tërheq interpretues nga e gjithë Shqipëria dhe më gjerë.

Shkodra

Shkodra, e vendosur në Shqipërinë veriperëndimore, është një nga qytetet më të vjetra të vendit dhe një qendër e rëndësishme kulturore dhe historike. Me një histori që daton mbi 2400 vjet, Shkodra ka luajtur një rol vendimtar në historinë shqiptare, si kryeqytet i Ilirisë dhe si qendër e rëndësishme gjatë sundimit osman.

Kalaja e Rozafës, me pozicionin e saj strategjik mbi liqenin e Shkodrës, ofron një pamje panoramike të lë pa frymë dhe rrëfen legjendën e gruas së rrethuar. Qendra e qytetit përmban arkitekturë historike, kafene të çuditshme dhe Katedralen e Shën Stefanit. Shkodra është gjithashtu një pikënisje ideale për të eksploruar Parkun Kombëtar të Liqenit të Shkodrës dhe Alpet



Shqiptare, duke ofruar mundësi të shumta për ekskursione dhe aktivitete në natyrë.

Durrësi

Durrësi, i vendosur në bregdetin e Adriatikut, është një nga qytetet më të vjetra dhe më të rëndësishme në Shqipëri. E themeluar nga grekët në shekullin e VII para Krishtit, ishte një port i rëndësishëm dhe qendër tregtare gjatë kohës romake. Qyteti është i njohur për amfiteatrin e tij romak, një nga më të mëdhenjtë në Ballkan, i cili mund të strehojë deri në 20 000 spektatorë.

Përveç mbetjeve të tij të lashta arkeologjike, Durrësi është sot një qytet modern me një jetë nate të gjallë, plazhe të njohura dhe një shëtitore buzë detit. Muzeu Arkeologjik i Durrësit ofron një koleksion të pasur gjetjesh që tregojnë historinë e gjatë të qytetit. Afërsia me Tiranën e bën Durrësin një destinacionin ideal për një udhëtim ditor nga kryeqyteti, duke ofruar një përzierje të historisë antike dhe modernes.

Vlorë

Vlora, e vendosur në bregdetin jugperëndimor të Shqipërisë, është një qytet me rëndësi të madhe historike dhe turistike. E themeluar nga grekët në shekullin e 6 para Krishtit, Vlora njihet si vendi ku Shqipëria shpalli pavarësinë nga Perandoria Osmane në 1912. Qyteti ofron një kombinim të bukurive natyrore, plazheve të pacenuara dhe vendeve historike.

Muzeu i Pavarësisë është i domosdoshëm për këdo që viziton Vlorën, pasi tregon historinë e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Qyteti është gjithashtu afër Parkut Kombëtar të Llogorasë dhe Rivierës Shqiptare, duke e bërë atë një bazë të përsosur për të eksploruar disa nga plazhet më të bukura të vendit. Jeta e natës në Vlorë është e gjallë, me restorante, bare

dhe klube të shumta që gjallërojnë qytetin gjatë gjithë vitit.

Sarandë

Saranda, e vendosur në bregdetin e Jonit, është një nga destinacionet turistike më të njohura të Shqipërisë, veçanërisht gjatë muajve të verës. Qyteti është i famshëm për ujërat e tij të kristalta, plazhet me rrë dhe klimën mesdhetare. Saranda është gjithashtu pika kryesore e hyrjes për të vizituar sitin arkeologjik të Butrintit, një sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

Butrinti, një qytet i lashtë greko-romak, ofron një pamje magjepsëse në historinë e lashtë me mbetjet e tij të ruajtura mirë, duke përfshirë një teatër, pagëzimore dhe tempuj të shumtë. Saranda është gjithashtu e njohur për jetën e saj të gjallë të natës dhe restorantet e shumta që ofrojnë specialitete lokale dhe ushqime të freskëta deti. Afërsia me ishullin grek të Korfuzit e bën Sarandën një bazë ideale për udhëtime ditore.

Korça

Korça, e vendosur në juglindje të Shqipërisë, njihet si “djepi i kulturës shqiptare”. Qyteti është një qendër e rëndësishme kulturore dhe arsimore dhe është shtëpia e shumë muzeve, shkollave dhe institucioneve kulturore. E themeluar në mesjetë, Korça ka një traditë të gjatë të prodhimit të birrës, muzikës dhe artit.

Muzeu Kombëtar i Arsimit, i vendosur në shkollën e parë shqipe, është një pikë referimi e rëndësishme që tregon historinë e arsimit në Shqipëri. Korça është gjithashtu e famshme për festivalin e përvitshëm të birrës, i cili tërheq mijëra vizitorë nga i gjithë vendi dhe jashtë tij. Duke ecur nëpër rrugët me kalldrëm të qytetit të vjetër, mund të admironi shtëpitë tradicionale të stilit osman dhe të vizitoni Katedralen Ortodokse të Shën Gjergjit.



KOLONEL HYSNI GJERGJI

"Kolona e pestë", nga Madridi i 1936, në Kievin e vitit 2024

Historikisht "Kolona e pestë" (spanjisht: quinta columna) është një përshkrim figurativ i mbështetësve të fshehtë të armikut, të cilët janë të përfshirë në aktivitete, propagande të huaj, sabotazhi, spiunazhi, nxitje trazirash etj. Koncepti u përdor për herë të parë në vitin 1936, gjatë Luftës Civile Spanjolle, kur katër kolona të ushtrisë së gjeneralit Franco po përparonin drejt Madridit, dhe "kolona e pestë" (mbështetësit e tij në qytet) ishte përgatitur për të kryer sabotim nga brenda.

Në demokraci kolona e pestë simbolizon fuqinë e fshehtë, e cila përpiqet të rrëzojë katër kolonat e demokracisë që janë: drejtësia, uniteti, liria dhe barazia. Libri i Louis De Jong, "Kolona e Pestë Gjermane në Luftën e Dytë Botërore", u botua në 1956, në Shtetet e Bashkuara. Vëzhgimet dhe përfundimet e Louis De Jong ishin jashtëzakonisht të vlefshme atëherë por të vërtetura dhe më të rëndësishme sot, gjatë luftës në Ukrainë. Autori e analizoi në detaje rolin tinëzar të pakicës gjermane në vende të ndryshme dhe u përpoq të zbulonte se në cilat grupe të tilla njerëzish u shndërruan në kolonën e pestë. Louis De Jong tregon për një sërë faktorësh që kontribuuan në përpjekjet e nazistëve për t'i kthyer komunitetet gjermane jashtë vendit në një kolonë të pestë efektive që punon për Rajhun, të cilat ishin: madhësia relative e një grupi; afërsia territoriale me Gjermaninë; përqendrimi gjeografik; shkalla e zhvillimit ekonomik; statusi social i tyre; lidhjet historike me Gjermaninë si dhe ndjenja e një pakice të shtypur. Sa i përket funksioneve të kolonës së pestë në kohë lufte, ato ishin të kufizuara në ndihmën e trupave gjermane nga brenda gjatë agresionit (zbulim, sinjalizim, sabotim, shmangie nga mobilizimi, deri në pushkatimin e bashkëqytetarëve të tyre pas shpine). Kolona e pestë ushtarake është si një përfundim logjik, si kulmi i zhvillimit të kolonës së pestë politike.

L. De Jong thekson se kolona e pestë gjermane përfshinte çdo grup popullsie jashtë Rajhut që kontribuonte në zgjerimin territorial nacional-socialist, duke vepruar në përputhje me udhëzimet sekrete të autoriteteve gjermane. Kryeqyteti i Norvegjisë, Oslo dhe portet kryesore detare nuk u pushtuan me armë. Ato u pushtuan nga një komplot gjigant që mund të quhet një nga komplotet politike më të guximshme dhe të mirë organizuara të 100 viteve të fundit. Përdorimi i ryshfetit dhe agentët e dërguar fshehurazi, duke u mbështetur tek tradhtarët mes figurave të larta ushtarake në Norvegji, Hitleri arriti të krijonte një "kolonë të pestë" brenda vendit. Gjithçka që bëri, ishte rekrutimi i bashkëpunëtorëve nga ata që mbanin poste kyçe në qeverinë, ushtrinë dhe më së shumti në marinën norvegjeze.

Gjatë Luftës, palët kundërshtarë kombinojnë me zgjuarsia arsenalet teknikash psikologjike për të ruajtur moralin e popullatës së tyre, duke kërkuar të krijojnë pamjen më optimiste të mundshme edhe kur situata është e vështirë. Për këtë qëllim shtypen postera dhe broshura, prodhohen filma propagandistikë, ku edhe "e qeshura" është një armë e pamëshirshme. Ka një problem me luftimin e spiunëve dhe mbrojtjen e sekreteve shtetërore në kohë lufte.

Dikur, ky mision përmbushej vetëm nga sloganet e teksteve shkollore dhe të posterave sovjetike nga Lufta e Dytë Botërore të përdorura edhe në ushtrinë tonë: "Mos fol!", "Mos fol pranë telefonit! Një bisedë pa vend, është një dhuratë për një spiun të huaj!", "Mos fol, armiku po dëgjon!", "Të flasësh është të ndihmosh armikun!", "Ruaj rreptësisht sekretet ushtarake dhe shtetërore!". Si gjermanët, ashtu dhe britanikët e amerikanët kishin klishe pothuaj të ngjashme propagandistike gjatë luftës së dytë botërore. Propaganda vazhdoi edhe gjatë Luftës së Ftohtë, por e nxori lakuriq dobësinë dhe dështimin e socializmit. Megjithatë Rusia nuk hoqi dorë, duke pritur fuqizimin e saj ekonomik deri sa sulmoi ushtarakisht Ukrainën.

Në javën e parë të pushtimit në shkallë të gjerë të Ukrainës nga Rusia, ndodhën një sërë ngjarjesh që analistët e sigurisë dhe inteligjencës bëjnë të mendojmë se këto nuk janë rastësi; Nuk



kishte trupa ukrainase në kufirin me Bjellorusinë, vetëm roje kufitare. Aeroporti Zhulyany nuk ruhej pothuajse fare. Zvogëlimi i çuditshëm i Forcave të Armatosura ndodhi në 2019-2020. Për shembull, njësisë ushtarake A0229 (batalioni i 23-të i veçantë i tankeve), e cila ishte e vendosur në rrethin Ovruch të rajonit Zhytomyr, në kufi me Bjellorusinë, u shpërbë. Rastësi (jo) e çuditshme, ishte se pikërisht nga atje filloi ofensiva kryesore e trupave ruse. Ende nuk është zyrtarisht e qartë me urdhër të kujt u pastruan fushat e minuara nga Krimea e pushtuar në territorin e Ukrainës në vitin 2021. Heroi i Ukrainës, gjenerallejtënant i Shërbimit të Sigurisë së Ukrainës (SBU) Hryhorii Omelchenko sugjeron: "Dorëzimi i jugut të Ukrainës: Neglizhencë kriminale apo tradhti e lartë?".

Si pjesë e "ndërtimit të madh", u rindërtua dhe u zgjerua autostrada për në Çornobil, e cila përdorej nga 1-2 makina në ditë?! Ishte kjo rrugë e modernizuar që u bë një nga rrugët kryesore të përdorura nga ushtria ruse në ofensivën e shkurtit 2022. Në muajt e parë të ofensivës së Rusisë, një sërë ndërmarrjesh shtetërore që supozohej të angazhoheshin në blerjen e armëve, tërhoqën 243 milionë dollarë. Ekspertja e energjisë bërthamore Olha Kosharna tha se 70% e blerjeve të Energoatom, në vitin 2022, janë bërë nga centrali i Zaporizhias. Ajo tha se nëse analizoni aktivitetet e Energoatom, mund të shihni se kompania ishte duke i pritur pushtuesit. Më 14 qershor 2023, inteligjenca ushtarake ukrainase SBU, akuzoi një kompani të Kievit në bashkëpunim me Rosatom të sanksionuar.

Më 24 shkurt 2022, kolona e parë e pushtuesve rusë u formua nga njësitë speciale të ndërhyrjes së shpejtë me shkopinj dhe mburoja, pasi prisnin rezistencë të dobët. Në pajisjet e shkatërruara të agresorëve, ushtarët ukrainas gjetën uniforma ceremoniale, racione ushqimore për tre ditë, municion të pakët dhe "listën e vrasjeve" të qytetarëve ukrainas që do të eliminoheshin në ditët e para të pushtimit. Nga erdhën këto lista? Kolona e pestë ruse në

Ukrainë qartësisht ndihmoi në përpilimin e tyre paraprak.

Funksionet e "kolonës së pestë" janë: "subversion" në kohë paqeje dhe "sabotim" në kohë lufte. Rastet e përpjekjeve të "përmbysjes paqësore" në Ukrainë përfshijnë talljen dhe ironinë me gjuhën ukrainase, e cila ishte një tipar konstant i pothuajse çdo shfaqjeje të "Kvartal-95" për gati dy dekadat e fundit. Ajo u krye në mijëra metoda dhe forma të ndryshme kohore dhe hapësinore. Projektligji "Për përdorimin e gjuhës angleze në Ukrainë" konsiderohet një rast "subversioni paqësor". Kjo nismë e miratuar nga parlamenti goditi pozicionin e gjuhës ukrainase në dublimin e filmave ukrainas dhe ndikimin negativ të gjuhës ruse si një armë masive për mendjet e ukrainasve.

Megjithëse aktivitetet e "kolonës së pestë" zakonisht shihen si të vetëdijshme dhe të qëllimshme, shumë njerëz ndihmojnë pa dashje të ashtuquajtur "idiotë të dobishëm", por që objektivisht kanë kontribuar në zgjerimin e influencës së Rusisë. Së bashku me bashkëpunëtorët e qëllimshëm (simpatizantët e Rusisë dhe "agentët e fjetur"), ka edhe shumë vëzhgues pasivë, të cilët, pa marrë pjesë drejtpërdrejt në luftën e informacionit, kontribuojnë në pushtimin rus qoftë dhe me indiferencën e tyre.

Korrupsioni është problem i madh i ushtrisë sidomos në kohë lufte, pasi ushqyen dhe gërryen besimin e ushtarit tek komandanti, të popullit tek elita që pasurohet mbi gjakun e bijve të tij. Dezertimet dhe shmangiet nga detyrimi për t'i shërbyer nën armë atdheut, kanë kryesisht këtë arsye. Kolonat e pesta e ushqejnë këtë plagë me qëllim përçarjen dhe humbjen e kohezionit të ushtrisë kundërshtarë. Korrupsioni në kohë lufte është më shumë se një krim shtetëror dhe rezulton të jetë pjesë integrale e qeverisë ukrainase, i cili nuk u zhduk as gjatë luftës, madje as në Ministrinë e Mbrojtjes. Autoritetet e korrupuara ukrainase kanë ndihmuar përfaqësuesit e armikut, që t'i shmangin sanksionet ndërkombëtare. David Arakhania deputet i partisë së Zelenskit, shkroi një letër në fillim të luftës, duke dëshmuar se oligarku i njohur Abramovich



“NË DEMOKRACI KOLONA E PESTË SIMBOLIZON FUQINË E FSHEHTË, E CILA PËRPIQET TË RRËZOJË KATËR KOLONAT E DEMOKRACISË QË JANË: DREJTËSIA, UNITETI, LIRIA DHE BARAZIA. LIBRI I LOUIS DE JONG, “KOLONA E PESTË GJERMANE NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE”, U BOTUA NË 1956, NË SHTETET E BASHKUARA. VËZHGIMET DHE PËRFUNDIMET E LOUIS DE JONG ISHIN JASHTËZAKONISHT TË VLEFSHME ATËHERË POR TË VËRTETUARA DHE MË TË RËNDËSISHME SOT, GJATË LUFTËS NË UKRAINË. AUTORI E ANALIZOI NË DETAJE ROLIN TINËZAR TË PAKICËS GJERMANE NË VENDE TË NDRYSHME DHE U PËRPOQ TË ZBULONTE SE NË CILAT GRUPE TË TILLA NJERËZISH U SHNDËRRUAN NË KOLONËN E PESTË.

kishte “shpëtuar” jetën e mbi 400 000 ukrainasve. Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelenskyy mbi këtë rekomandim i kërkoi Joe Biden që të hiqte oligarkun rus Roman Abramovich nga lista e sanksioneve, në mënyrë që Abramovich të mund të vazhdojë të ndërmjetësojë në negociatat me Rusinë.

Disa nga titujt në median ukrainase, deri në nëntor 2023, lidhur me korrupsionin në FA janë: Ndalohet kreu i Këshillit Rajonal të Ternopilit dhe dy Zëvendës Shefat e Departamentit Ushtarak”; “Skandal korrupsioni. Komisari ushtarak i Odesës shkarkohet nga detyra”; “Koloneli i Universitetit të Lviv të Sigurisë u arrestua për ryshfet”; “Ndalohet zyrtari i Shërbimit Përmbarrimor të Lviv për ryshfet prej 1300 dollarësh”; “Dogana e Lviv zbuloi një skemë zhvatjeje në zhdoganimin e makinave”; “Zëvendës kryeprokurori Ushtarak i Zakarpattia u arrestua për ryshfet”; “Drejtori i Kolegjit Lokal u kap në rajonin e Ternopilit për ryshfet”; “Ish-zëvendësministri i Infrastrukturës Vasyl Lozynskyi arrestohet sërish. Nuk kanë fund historitë e luftës kundër këtij kanceri në trupin që lëngon të shtetit ukrainas. Më 2 shkurt 2023, SBU raportoi se oficerët e zbatimit të ligjit kishin ekspozuar dhe bllokuar një skemë korrupsioni në shkallë të gjerë të organizuar nga udhëheqja e Qarkut Ushtarak Rajonal Sumy.

Për shtetin ukrainas, korrupsioni jo vetëm nuk është zhdukur gjatë luftës, por madje është bërë më cinik. Zyrtarët i kryejnë marrëveshjet e tyre kriminale nën maskën e parullave patriotike dhe nacionaliste. Në fillim të korrikut 2023, kreu i një gjykate në rajonin Cherkasy, arriti deri atje sa të justifikojë agresionin e armatosur të Federatës Ruse kundër Ukrainës. A nuk është ky një konfirmim i plotë i ekzistencës së “kolonës së pestë” në sistemin e drejtësisë ukrainase?

Vetëm në periudhën janar-maj 2023, Prokuroria e Përgjithshme hapi më shumë se 2300 procedime për nenet “tradhti e lartë” dhe “bashkëpunim me pushtuesin”. Megjithatë, vetëm rreth 11% e çështjeve janë sjellë në gjykatë. Oficerët e SBU zbulojnë çdo ditë propagandistë në internet që bëjnë thirrje për aleancë me një vend terrorist dhe mohojnë agresionin e tij. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për agjentë të ndikimit ose “idiotë të dobishëm”, por për diversantë, sabotatorë, tradhtarë, bashkëpunëtorë dhe agjentë të mirë përgatitur në misionin e tyre. Nga aktiviteti i tyre, një magazinë me rezerva të mëdha municionesh u shkatërrua pranë Khmelnytsky natën e 13-14 majit 2023, e cila ndikonte në vazhdimin e ofensivës së ushtrisë ukrainase.

Një “pesëkolumnist” i hapur i Rusisë në Ukrainë, Vyacheslav

Boguslaev deputet ukrainas, është akuzuar për tradhti të lartë. Lind një pyetje e natyrshme: çfarë shikonte populli kur e zgjodhi në parlament, te një person që me veprimet e tij cenonte integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës për një kohë shumë të gjatë? Boguslaev, megjithëse në burg, ai është optimist për shkëmbim me një zbulues ukrainas të kapur nga pala ruse, sipas praktikës ndërkombëtare të shkëmbimit të robërve të luftës.

Më 20 qershor 2023, SBU zbuloi dy agjitorë të internetit në Kharkiv, të cilët mbështetën agresionin e armatosur të Rusisë; më 27 qershor, SBU arrestoi autorin e një sulmi raketor rus në Kramatorsk; më 30 qershor, SBU neutralizoi rrjetin e agjentëve të FSB-së në Kharkiv, të cilët po synonin qytetin me raketahedhës rusë Smerch dhe Uragan; në qershor 2023, prokurori i Mykolaiv mori një dënim të përgjithshëm për tradhti të lartë; më 22 tetor 2023, një informator që po koordinonte të lokalizonte me GPS, sulmet ajrore ruse në qytet u zbulua në Mykolaiv; në rajonin e Zhytomyr, SBU kapi një agjent rus brenda ushtrisë ukrainase, i cili mblidhte informacion për FSB-në; një punonjës i stacionit Ukrzaliznytsia, i cili regjistronte koordinatat e stacioneve hekurudhore dhe urave, përmes të cilave po transportoheshin armët dhe municionet e rënda etj.

Presidenti aktual çek Peter Pavel, beson se rusët duhet t’i nënshtrohen masave të shtuara të sigurisë. Sipas tij, rusët që jetojnë në vendet evropiane duhet të jenë “nën vëzhgimin e shërbimeve të inteligjencës” edhe nëse hapur kundërshtojnë luftën me Ukrainën. “Më vjen keq për këta njerëz, por ky është çmimi i luftës. Qarkullon argumenti se bota duhet ta perceptojë atë që po ndodh në Ukrainë vetëm si “luftë e Putinit” dhe jo si “luftë e Rusisë”.

Ky është një argument i paplotë, pasi duhet të vlerësojmë mbështetjen reale që presidenti Putin ka në popullatën ruse, pa mohuar manipulimet në zgjedhjet e 2024, që e konfirmuan deri në 2030. Në Europë, shohim se ka shumë njerëz që e mbështesin luftën, madje bëjnë thirrje që lufta të përhapet edhe në vendet e tjera. Me këto argumente ne duhet ta quajmë atë jo vetëm “luftë të Putinit” por edhe “lufta e Rusisë”, e cila mund të përhapet dhe nuk do të kurseje as Shqipërinë dhe as Kosovën. Siç tregon përvoja botërore, në çdo luftë dhe në çdo vend, ku edhe Shqipëria nuk bën përjashtim, ekziston kolaboracionizmi, lufta kundër të cilit është një komponent i domosdoshëm i fitores.

Artikulli “Bashkëpunëtorët e vullnetshëm të Rusisë”, i botuar më 8 qershor 2023, në “punët e jashtme”, tërheq vëmendjen për problemin e bashkëpunëtorëve rusë, veçanërisht në territoret e pushtuara, si dhe në shtetet e synuara nga Rusia, ku dhe vendi ynë bën pjesë. Së bashku me bashkëpunëtorët e qëllimshëm, ka edhe shumë simpatizues rusë apo vëzhgues pasivë, të cilët edhe pse nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në luftë, kontribuojnë në pushtimin rus nëpërmjet orientimit të tyre ideologjik.

Në trajtimin e problemit të “kolonës së pestë”, bashkëpunëtorëve rusë dhe atyre që dyshohen ose akuzohen për bashkëpunim, jo vetëm Ukraina por edhe çdo shtet tjetër demokratik, përballet me një zgjedhje të vështirë. Axhenda e sotme, përfshin jo vetëm konfrontim të armatosur me agresionin rus, por edhe luftë efektive kundër “kolonës së pestë” brenda shteteve të synuara. Luftërat edhe kur nuk jemi të përfshirë drejtpërdrejt duhet të lexohen, të nxirrem mësim me qëllim parandalimin dhe ndërprerjen në kohë të fenomeneve të ngjashme në vende të tjera. Siç tregon analiza e krizës para dhe gjatë luftës në Ukrainë e përshkruar më lart, rezultojnë se asnjë vend nuk është i sigurt ndaj kolonës së pestë si armë e luftës së fshehtë. Edhe ne shqiptarët duhet të “zgjohemi” nga kambanat e Kievit, pasi me siguri edhe në kohën e përgatitjes së këtij shkrimi, kundërshtarët tanë jo vetëm rusë, po përgatisin njerëzit, dhe po krijojnë rrethanat për të na goditur, përmes “kolonave të pesta” të tyre.

Rreshtimi ynë në NATO përkrah shteteve demokratike perëndimore kundër agresionit rus, ekzistenca e korrupsionit, e idiotëve të dobishëm, e vullnetarëve të devotshëm dhe “qelizave të fjetura”; janë terreni shumë pjellor për të patur “kolona të pesta” brenda institucioneve, madje edhe brenda ushtrisë sonë. Është koha që edhe ne të njohim dhe përgatitemi të përballemi me këtë kërcënim të padukshëm. Ato rrezikojnë të shkaktojnë rrëzimin e institucioneve të shtetit, jo nga zjarri i raketave, por më keq akoma, me më shumë dhimbje, pasi përgatiten dhe ekzekutohet nga shqipfolës, si në veri ashtu dhe në jug të Shqipërisë.

Tradhtarët në paqe janë më të rrezikshëm se ata në luftë, pasi në luftë ata qëndrojnë në radhët e fundit, kurse në paqe janë në radhët e para; në luftë ata kanë frikë nga populli, ndërsa në paqe populli iu frikësohet atyre; në luftë është në pikëpyetje fati i një beteje, ndërsa në paqe është pikëpyetje fati i një populli. Ata shpeshherë janë në shkrim me ne, shfaqen në publik dhe media më patriotë se ne, akuzojnë dhe denoncojnë luftën “e padrejtë” më ashpër se ne, por këtë e bëjnë thjesht për të fituar postin e duhur, nga ku mund të na godasin më fort, më rëndë dhe më me efektivitet në dobi të shtetit që i përdor.

"Të ndërtohet Shqipëria e re demokratike e popullore sipas vullnetit të popullit", 80 vjet nga Kongresi i Përmetit

Punimet e Kongresit filluan, më 24 maj 1944, ditë e mërkurë, në orën 09:00. Gjithsej u zgjodhën 200 delegatë. Vendimi për thirrjen e këtij kongresi u mor, më 15 prill 1944, nga Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm Antifashist NAÇL

KRITERET DHE PROCEDURAT E ZGJEDHJES SË DELEGATËVE

Në rezolucionin e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm thuhej: "Në Kongres të përfaqësohen zonat e lira, zonat e pushtuara nga armiku, brigadat dhe batalionet partizane e vullnetare, Bashkimi i Rinisë Antifashiste me 10 delegatë dhe Bashkimi i Gruas me 5 delegatë". Në zonat e çliruara dhe formacionet e ushtrisë delegatët do të zgjidheshin demokratikisht me votim të hapur nga 3 deri në 5 vetë për çdo komunë. Në zonat e paçliruara do të caktoheshin nga këshillat e qarqeve apo të qyteteve.

Delegatët e Kongresit u zgjodhën nga mbledhjet e delegatëve të komunave apo të njërive të ushtrisë. Në qarkoren e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm thuhej se: "Delegatët komunalë dhe sidomos delegatët për në Kongres, duhet të zgjidhen nga radhët e militantëve dhe luftëtarëve më të provuar dhe që përfaqësojnë me të vërtetë popullin".

Në këtë mënyrë në Kongres u përfaqësua i gjithë populli, nga Jugu në Veri, nga terreni dhe ushtria, me parti dhe pa parti, nga radhët e klerit, rinia dhe gruaja. Gjithsej u zgjodhën 200 delegatë.

Pse u mbledhën në Përmet?

Së pari, krahina e Përmetit dhe krahinat përreth kishin një pozitë të favorshme strategjike, që mund të mbrohej më mirë nga forcat partizane dhe ato popullore.

Së dyti, sepse qyteti i Përmetit ishte i çliruar dhe, me këtë, duhej t'i tregohej opinionit të brendshëm dhe të jashtëm se lufta e popullit shqiptar kishte kaluar nga faza e luftës partizane, në një luftë të rregullt me veprime të mëdha të bashkërenduara, kishte kaluar në fazën e çlirimit të qyteteve.

Së treti, për të nderuar kujtimin e udhëheqësve të mëdhenj të Rilindjes Kombëtare, që lindën në truallin e Përmetit, Poetin e madh Naim Frashërin, filozofin dhe dijetarin e shquar, Sami Frashërin dhe revolucionarin e madh Abdyl Frashërin.

Punimet

Punimet e Kongresit filluan, më 24 Maj 1944, ditë e mërkurë në orë 09:00, në prani të 200 delegatëve dhe të një numri të ftuarish. Ishin ftuar edhe përfaqësuesit e misionit ushtarak britanik, por ata nuk mundën të merrnin pjesë.

Kongresin e çeli me një fjalim të shkurtër Dr. Omer Nishani, i cili ndër të tjera tha: "Se ç'të drejta kemi ftuar me luftën tonë, e si do ta ngremë ne Shqipërinë e re demokratike e popullore, e dëshmon ky Kongres, do ta dëshmojnë përfundimet e tij".

Raportin "Zhvillimi i Luftës Nacionalçlirimtare të popullit

në lidhje me ngjarjet ndërkombëtare" e mbajti Enver Hoxha. Ai ndër të tjera tha: "Kjo që bëjmë sot, është një nga ngjarjet më të mëdha të popullit shqiptar. Për të parën herë populli dërgon përfaqësuesit e vet, që i ka zgjedhur lirisht e që ka besim në ta".

Ndërsa, duke bërë fjalë për sakrificat e mëdha që u bënë gjatë luftës tha: "Kemi pasur vuajtje dhe mundime të mëdha, me të cilat bijtë e popullit tonë, të plagosur, pa bukë, të zhveshur, në borë e furtunë, por me moralin kurdoherë të lartë, kanë treguar trimëri të padëgjua, me të cilat do të mburren me shekuj brezat e ardhshëm të popullit tonë".

1. Të ndërtohet Shqipëria e re demokratike e popullore sipas vullnetit të popullit, që sot e shpreh solemnisht në Këshillin e Përgjithshëm Antifashist NAÇL.

2. T'i ndalohet ish-mbretit Zog kthimi në Shqipëri dhe, të mos njihet asnjë qeveri që mund të formohej brenda ose jashtë vendit kundër vullnetit të popullit.

3. Të vazhdohej më me ashpërsi lufta kundër pushtuesve gjermanë dhe tradhtarëve shqiptarë, deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe vendosjen e pushtetit demokratik-popullor në të

gjithë vendin.

Kurse Këshilli i Përgjithshëm vendosi:

Vendimi mbi rishikimin dhe prishjen e gjithë marrëveshjeve politike dhe ekonomike që binin në kundërshtim me interesat e popullit dhe të kombit shqiptar.

Vendimi mbi shndërrimin e Ushtrisë NAÇL në ushtri të rregullt, me një udhëheqje të njësuar dhe me një komandë të përgjithshme.

Vendimi mbi dhënien e gradave në ushtri. Vendimi për kalimin e Ushtrisë në mësimje të përgjithshme për çlirimin e plotë të trojeve shqiptare. Kongresi miratoi veprimtarinë e përgjithshme të udhëheqjes së Luftës dhe udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NAÇL. Këto përbëjnë ligjet e para të pushtetit demokratik popullor. Këshillin e Përgjithshëm me 121 anëtarë që përfaqësonin të gjithë vendin dhe të gjitha shtresat shoqërore, pjesëmarrëse në luftë.

President, Baba Faja Martaneshi; Hasan Pulo dhe Koçi Xoxe, nënpresidentë dhe Enver Hoxha, Spiro Moisiu, Ramadan Çitaku, Sejfulla Malëshova, Dr. Ymer Dishnica, Liri Gega, Islam Radovicka, Nako Spiru, Tuk Jakova, Mustafa Gjinishi, Haxhi Lleshi, Gogo Nushi, Siri Shaplllo, Spiro Koleka, Qiriako Harito, Gjergj Kokoshi, Ollga Plumbi dhe Gaqo Tashko, anëtarë.

Sekretarë u zgjodhën: Koço Tashko e Sami Baholli.

U zgjodh Komiteti Antifashist me atributet e një qeverie provizore, të përbërë nga 11 anëtarë. Enver Hoxha, President, Myslym Peza nënpresident, Haxhi Lleshi i ngarkuar me Punët e Brendshme, Dr. Omer Nishani me Punët e Jashtme, Manol Konomi me Drejtësinë, Dr. Medar Shtylla, me Ekonominë, Ramadan Çitaku me Fianncën, Spiro Koleka me punët botore, Dr. Ymer Dishnica, me Shëndetësinë, Sejfulla Malëshova me Kulturën dhe Arsimin dhe Bedri Spahiu me Rindërtimin ekonomik.

U zgjodh edhe një Komision për zbulimin dhe vërtetimin e krimeve të pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, si dhe për zbulimin dhe vërtetimin e emrave të kriminelëve të luftës. Kongresi u drejtoi përshëndetje: Popujve dhe ushtrisë Sovjetike dhe Mareshalit Stalin, Presidentit Rosvelt, Kryeministrit anglez Winston Churchill, Mareshalit Tito, EAMIT grek, Fan Nolit për shqiptarët e SHBA-së. Të burgosurve dhe të internuarve brenda dhe jashtë vendit.



Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoană priti ministrin e Mbrojtjes të Bosnje-Hercegovinës, Zukan Helez në selinë e NATO-s. Ai përsëriti mbështetjen e fortë të NATO-s për sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës dhe angazhimin e palëkundur të Aleancës për partneritetin e saj afatgjatë me vendin.

NATO po mbështet përpjekjet e reformës së mbrojtjes të Bosnjës dhe Hercegovinës përmes një pakete të re për ndërtimin e kapaciteteve të mbrojtjes. Kjo do të ndihmojë në forcimin e aftësive të vendit në fusha si menaxhimi i krizave, mbrojtja kibernetike dhe lufta kundër terrorizmit. Aleatët kanë kontribuar tashmë me disa milionë euro dhe kanë premtuar një numër ekspertësh të çështjes për këtë qëllim.

Z. Geoană ripohoi gjithashtu se siguria e Bosnje-Hercegovinës ka rëndësi për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor dhe për zonën euro-atlantike më gjerësisht. Ai nënvizoi se thirrjet separatiste rrezikojnë të vënë në rrezik përparimin e arritur me vështirësi dhe përsëriti se NATO mbetet plotësisht e përkushtuar për të mbështetur Bosnjën dhe Hercegovinën në rrugën e saj euro-atlantike.

NATO e angazhuar për ndërtimin e paqes dhe stabilitetit në Bosnje-Hercegovinë

NATO dhe Bosnje-Hercegovina ndjekin një program bashkëpunimi të gjerë dhe reciprokisht të dobishëm, i cili përfshin mbështetjen për reformat demokratike, institucionale, të sektorit të sigurisë dhe të mbrojtjes. Programi i Reformës, si korniza kryesore e bashkëpunimit, ndihmon në drejtimin e përpjekjeve reformuese të vendit ndërsa vazhdon të ndjekë rrugën e tij euroatlantike.

Aleanca ka qenë e angazhuar për ndërtimin e paqes dhe stabilitetit afatgjatë në Bosnje-Hercegovinë që nga fillimi i viteve 1990, kur filloi të mbështesë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për t'i dhënë fund konfliktit në Bosnje-Hercegovinë. Ndërkohë që Bosnje-Hercegovina iu bashkua programit të Partneritetit për Paqe, PfP, në 2006, ajo u ftua t'i bashkohej Planit të Veprimit të Anëtarësimit, MAP, në 2010. Pjesëmarrja në MAP nuk paragjykon asnjë vendim për anëtarësimin e ardhshëm. Por në kuadër të Planit të Veprimit të Anëtarësimit, bashkëpunimi i vendit me NATO-n, strukturohet përmes Programit të Reformës së Bosnje-Hercegovinës, i cili përshkruan reformat që qeveria synon të ndërmarrë dhe lehtëson ofrimin e mbështetjes nga NATO ndaj këtyre përpjekjeve.

Për të lehtësuar bashkëpunimin, Bosnje-Hercegovina ka një mision diplomatik në selinë e NATO-s në Bruksel, Belgjikë, si dhe një zyrë ndërlidhëse në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Evropë në Mons, Belgjikë. Nga ana tjetër NATO ka një seli në Sarajevë me misionin kryesor për të ndihmuar autoritetet e Bosnje-Hercegovinës me reformat dhe angazhimet e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë në lidhje me programin PfP, dhe misionin dytësor të ofrimit të mbështetjes logjistike, etj, për Forcën e Bashkimit Evropian, EUFOR, në Bosnje dhe Hercegovinë. NATO i ofron mbështetje EUFOR Operacionit “Althea” sipas Marrëveshjeve të “Berlin Plus”. Në mjedisin e ndryshuar të sigurisë në Evropë, NATO po rrit mbështetjen e saj për partnerët, përfshirë Bosnje-Hercegovinën, për t'i ndihmuar të ndërtojnë aftësitë dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre. Në shkurt 2023, ministrat e Mbrojtjes aleate miratuan një paketë të re për ngritjen e kapaciteteve mbrojtëse për Bosnje-Hercegovinën. Kjo paketë ndihme do të forcojë aftësitë e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit, përfshirë fusha të tilla si menaxhimi i krizave, mbrojtja kibernetike, evakuimi aero-mjekësor dhe lufta kundër terrorizmit.

Aleanca, rol kyç në vendosjen e paqes

Pas luftës së viteve 1992-1995 në Bosnje-Hercegovinë, NATO luajti një rol kyç në zbatimin e Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit, përmes vendosjeve paqeruajtëse gjatë një periudhe nëntëvjeçare nga dhjetori 1995, deri në dhjetor 2004. Forca Implementuese e udhëhequr nga NATO, IFOR, u vendos në dhjetor 1995 për të zbatuar aspektet ushtarake të Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit dhe u zëvendësua një vit më vonë nga Forca e Stabilizimit e udhëhequr nga NATO, SFOR. SFOR-i ndihmoi për të ruajtur një mjedis të sigurt dhe për të lehtësuar rindërtimin e vendit pas luftës. Në dhjetor 2004, përgjegjësia kryesore për aspektet ushtarake të Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit iu dorëzua Bashkimit Evropian, i cili që atëherë po kryen operacionin e EUFOR-it “Althea” në Bosnje-Hercegovinë. NATO i ofron mbështetje EUFOR Operacionit “Althea”, sipas Marrëveshjeve të “Berlin Plus”.

Ndërsa Bosnje-Hercegovina iu bashkua programit të Partneritetit për Paqe në vitin 2006, më pas u ftua t'i bashkohej Planit të Veprimit të Anëtarësimit në vitin 2010, një program i NATO-s me këshilla, asistencë dhe mbështetje praktike të përshtatur për nevojat individuale të vendeve që dëshirojnë të

Stabiliteti në Ballkanin Perëndimor, NATO ripohon rëndësinë e partneritetit të saj me Bosnje-Hercegovinën



bashkohen me Aleancën. Pjesëmarrja në MAP nuk paragjykon asnjë vendim për anëtarësimin e ardhshëm, por vendi duhet të vazhdojë të ndjekë reformat demokratike dhe të mbrojtjes për të përmbushur aspiratat e tij euro-atlantike.

Për këtë qëllim, nën MAP, Bosnje-Hercegovina prezantoi Programin e saj të parë të Reformës në vitin 2019. Ky program përshkruan reformat që qeveria synon të ndërmarrë dhe lehtëson ofrimin e mbështetjes nga NATO ndaj këtyre përpjekjeve. Në fillim të vitit 2021, Bosnje-Hercegovina themeloi Komisionin për Bashkëpunim me NATO-n, i cili koordinon zbatimin e aktivitetave reformuese në kuadër të Programit të Reformës.

Pas pushtimit të plotë të Rusisë në Ukrainë në vitin 2022, NATO po rrit mbështetjen e saj për partnerët, përfshirë Bosnje-Hercegovinën, për t'i ndihmuar ata të ndërtojnë aftësitë e tyre dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre. Ministri i Mbrojtjes i Bosnje-Hercegovinës mori pjesë në Samitin e NATO-s 2022 në Madrid. Gjatë këtij samiti, aleatët ranë dakord për një sërë masash shtesë politike dhe praktike për të mbështetur vendin në forcimin e qëndrueshmërisë së tij, duke përfshirë zhvillimin e një pakete të re për Ndërtimin e Kapaciteteve Mbrojtëse, DCB. Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s miratuan paketën e re të DCB-së për Bosnje-Hercegovinën në shkurt 2023.

Bosnje-Hercegovina dhe NATO, bashkëpunim në fusha të ndryshme

Bashkëpunimi i Bosnjë-Hercegovinës me NATO-n është reciprokisht i dobishëm dhe ai përfshin një sërë fushash si ndërtimi i aftësive dhe ndërveprimit, mbështetje për operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO, por dhe një bashkëpunim më të gjerë.

Ndërtimi i aftësive dhe ndërveprimit: NATO mbështet zhvillimin e aftësive të sigurisë dhe të mbrojtjes në Bosnje-Hercegovinë përmes Iniciativës për Ndërtimin e Kapaciteteve të Mbrojtjes dhe të Sigurisë së Përkatshme, DCB. Paketa DCB 2023 për Bosnje-Hercegovinën përfshin iniciativa në fusha të tilla si menaxhimi i krizave, mbrojtja kibernetike, evakuimi aero-mjekësor dhe administrimi i pasojave të incidenteve që përfshijnë substanca kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore, CBRN.

Bosnje-Hercegovina po punon për të zhvilluar forca të armatosura plotësisht profesionale, të cilat janë të ndërveprueshme me forcat e NATO-s dhe kanë staf nga vullnetarë që plotësojnë standarde të larta profesionale. Për këtë qëllim, vendi ka marrë pjesë në Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit të PfP, PARP, që nga maji 2007. Roli i PARP është të sigurojë një bazë të strukturuar për identifikimin e forcave dhe aftësive që mund të jenë në dispozicion të Aleancës për trajnime shumëkombëshe, ushtrime dhe operacione paqeruajtëse dhe menaxhuese të krizave. Ai gjithashtu shërben si mekanizmi kryesor i përdorur për të udhëhequr dhe matur përparimin e mbrojtjes dhe reformës ushtarake.

Në vitin 2022, si pjesë e programit të konceptit të vlerësimit dhe reagimit të aftësive operacionale, OCC E&F, i cili është krijuar për të vlerësuar nivelin e ndërveprimit të njësive partnere, Bosnje-Hercegovina certifikoi me sukses një

grup-batalioni të lehtë të këmbësorisë sipas standardeve të gatishmërisë luftarake të NATO-s.

Bosnje-Hercegovina ka deklaruar një sërë forcash dhe asetesh si potencialisht të disponueshme për aktivitetet e PfP-së, duke përfshirë aftësitë inxhinierike, depozitimi i mjeteve shpërthyes, dhe pajisjet përkatëse. Që nga viti 2014, nën Iniciativën e Ndërveprueshmërisë së Partneritetit, vendi ka marrë pjesë në Platformën e Ndërveprueshmërisë, e cila bashkon aleatët me partnerë të përzgjedhur që janë kontribues aktivë në operacionet e NATO-s.

Bosnje-Hercegovina është një pjesëmarrëse aktive në programin e përshtatur, Ndërtimi i Integritetit (BI), i cili fokusohet në qeverisjen e mirë dhe përdorimin transparent dhe efektiv të burimeve të mbrojtjes. Qendra e Trajnimit për Operacionet e Mbështetjes së Paqes (PSOTC) e vendit, e akredituar nga NATO ofron trajnime ekspertësh mbi ndërtimin e integritetit dhe tema të tjera për NATO-n dhe vendet partnere.

Mbështetje për operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO: Që nga viti 2009, Bosnje-Hercegovina kontribuoi me oficerë në Forcën Ndërkombëtare të Ndihmës për Sigurinë, ISAF, të udhëhequr nga NATO në Afganistan, si pjesë e kontingjenteve daneze dhe gjermane, dhe gjithashtu kontribuoi në misionin e saj pasues të Mbështetjes së Vendosur, RSM.

Bashkëpunim tjetër më i gjerë: Në kuadrin e Programit të Shkencës për Paqe dhe Siguri (SPS), fushat kryesore për bashkëpunim me Bosnje-Hercegovinën përfshijnë teknologjinë e avancuar, zbulimin dhe pastrimin e minave dhe municioneve të pashpërthyer, mbrojtjen kibernetike, kundër-terrorizmin dhe aspektet njerëzore dhe sociale të sigurisë. Veçanërisht, shkencëtarët nga Bosnje-Hercegovina janë të përfshirë në një projekt kërkimor SPS që synon të rrisë sigurinë e komunikimeve, duke përdorur teknologjinë kuantike në rrjetet 5G.

Aktivitetet e përfunduara së fundmi që përfshijnë Bosnje-Hercegovinën përfshijnë zbatimin në të gjithë Ballkanin Perëndimor të Sistemit të Komandës së Incidentit të gjeneratës tjetër, NICS, një softuer komandimi dhe kontrolli i bazuar në ueb, që lehtëson bashkëpunimin në të gjitha nivelet e gatishmërisë, planifikimit, reagimit dhe rimëkëmbjes gjatë fatkeqësive të natyrës dhe incidentet e tjera. Përveç kësaj, shkencëtarët në Bosnje-Hercegovinë kanë punuar në zhvillimin e teknologjive të ndryshme për t'u marrë me kërcënimin e rreziqeve shpërthyes, përfshirë përmes realitetit virtual të shtuar dhe sistemeve të zgjeruara të zbulimit. Bosnje-Hercegovina po zhvillon aftësitë e saj kombëtare për menaxhimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive në konsultim me aleatët, duke përfshirë zhvillimin e kuadrit ligjor për përballimin e emergjencave civile dhe punën për krijimin e një sistemi informacioni për krizat civile për të koordinuar aktivitetet në rast emergjence.

Në maj 2014, Bosnje-Hercegovina kërkoi ndihmë nga Qendra Euro-Atlantike e NATO-s, për Koordinimin e Reagimit ndaj Fatkeqësive (EADRCC) pas përmbytjeve shkatërruese që goditën vendin. NATO koordinoi ndihmën emergjente nga vendet aleate dhe partnere, duke dërguar helikopterë, anije, ujë të pijshëm, ushqim, strehim dhe fonde. Në vitin 2017, Bosnje-Hercegovina priti stërvitjen vjetore të gatishmërisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive EADRCC që mblodhi së bashku aleatët, partnerët dhe organizatat ndërkombëtare. EADRCC është mekanizmi kryesor i NATO-s për reagimin ndaj emergjencave civile në zonën Euro-Atlantike. Ai është aktiv gjatë gjithë vitit, funksionon në baza 24/7 dhe përfshin të gjithë aleatët e NATO-s dhe vendet partnere. Qendra funksionon si një sistem kleringu për koordinimin e kërkesave dhe ofrimit të ndihmës, kryesisht në rast fatkeqësish natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu.

Bosnje-Hercegovina dhe NATO synojnë të përmirësojnë aksesin e publikut në informacion mbi përfitimet e bashkëpunimit me NATO-n, për të gjithë njerëzit që jetojnë në vend dhe për anëtarësimin e mundshëm të vendit në Aleancë. Për këtë qëllim, ekziston një strategji kombëtare e komunikimit e NATO-s.

Vëmendje e veçantë i kushtohet aktivitetëve që kërkojnë qëndrueshmëri dhe që lidhin palët kryesore të interesuara si qeveria, shoqëria civile dhe media. Diplomacia publike konsiderohet si një fushë kyçe që ka nevojë për përpjekje dhe burime të përkushtuara për të informuar publikun dhe autoritetet në Bosnje-Hercegovinë për NATO-n. Ekziston nevoja për të siguruar informacion të saktë, për të luftuar dezinformimin dhe për të theksuar përfitimet e përpjekjeve për reforma në Bosnje-Hercegovinë. Selia e NATO-s në Sarajevë siguron burime në terren dhe punon me disa aleatë.

500 vjet më parë, Nostradamus parashikoi një luftë të madhe për vitin 2024

Kush ishte Nostradamus?

Nostradamus ishte një astrolog francez i lindur në fillim të shekullit të 16-të. Ai punoi si mjek, por ai është i famshëm për aftësinë e tij të supozuar për të parashikuar të ardhmen dhe është merita për parashikimin e shumë ngjarjeve të mëdha botërore. Disa pretendojnë se ai parashikoi me sukses ngritjen e



Adolf Hitlerit, fillimin e pandemisë së koronavirusit dhe madje edhe vrasjen e presidentit amerikan John F. Kennedy. Epo, parashikimet nga mistika për vitin 2024 pretendojnë se mund të ketë dramë për familjen mbretërore, një shpërthim lufte dhe një cunami të madh.

Edhe pse ne e njohim vetëm me një emër, ai në fakt lindi me emrin Michel de Nostredame. Nostradamus është forma latine e emrit të tij. Ai lindi më 14 dhjetor 1503, në jug të Francës në Saint-Rémy-de-Provence.

Profecitë e tij të para erdhën nga pikëllimi

Besohet se Nostradamus filloi të parashikonte të ardhmen pas vdekjes tragjike të gruas dhe fëmijëve të tij nga një shpërthim murtaje në Francë. Ai filloi të udhëtonte nëpër Evropë, duke mësuar rreth misticizmit hebre dhe teknikave astrologjike.

Vepra e tij më e madhe

Kur Nostradamus u kthye në Provence, ai botoi të parën nga profecitë e tij në 1555 në atë që u bë vepra e tij më e madhe, “Profecitë”. Libri përbëhet nga 942 parashikime.



Parashikimet e tij janë analizuar edhe sot e kësaj dite. Një nga arsytet pse parashikimet e Nostradamus vazhdojnë të magjepsin njerëzit është sepse ato ishin gjithmonë të paqarta dhe nuk përfshinin kurrë data. Prandaj, parashikimet e tij mund të zbatoheshin në disa ngjarje dramatike gjatë shekujve.

Parashikimet për vitin 2024:

Ndryshimet klimatike do të bëhen katastrofike

Nostradamus përdori imazhet biblike kur bëhej fjalë për vizionet e tij për botën, veçanërisht kur shkroi për fundin e botës. Dhe këto imazhe janë bërë më të besueshme me zhvillimin e ndryshimeve klimatike.



Sipas disa interpretuesve të profecive të tij, shkrimet e tij të mëparshme hedhin themelet për një botë që përballet me efektet katastrofike të ngrohjes globale dhe viti 2024 nuk do të jetë ndryshe.

Disa nga analistët e tij tregojnë një tekst që përshkruan detet, lumenjtë dhe liqenet që vlojnë, së bashku me parashikimin e një thatësire të madhe. Ata sugjerojnë se kjo është provë se Nostradamus parashikoi ndryshimet klimatike që çuan në një pjesë të tokës që të bëheshin të pajetueshme për njerëzit dhe kafshët.



Një cunami masiv mund të godasë dhe të sjellë me vete një zi të madhe buke. Nostradamus parashikoi gjithashtu cunami, pasi ai pretendoi se një seri “përmytjesh të mëdha” do të godasin



pjesë të botës, vetëm për t’u pasuar nga një “uri e madhe buke”.

Parashikimet e tij të zymta lexonin: “Toka e thatë do të bëhet më e thatë dhe do të ketë përmytje të mëdha”. Ai gjithashtu shkroi për një “uri shumë të madhe përmes valës së dëmshme”, e cila do të lë të kuptohet në mundësinë e cunamit që të ndikojë tokën bujqësore.

Një kohë e shkatërruar nga lufta

Vitet e fundit, cikli global i lajmeve është mbizotëruar nga shpërthimi i luftës. Në shkurt 2022, Rusia pushtoi Ukrainën, duke nxitur tensionet midis superfuqive të botës.

Dhe në vjeshtë të vitit 2023, Izraeli i shpalli luftë grupit militant palestinez të Hamasit pas sulmit të tyre, i cili çoi në bombardime intensive të Rripit të Gazës dhe mijëra vdekje të tjera.


Analistët e punës së Nostradamus pohojnë se tekstet e tij për fat të keq parashikojnë konflikt të mëtejshëm për vitin 2024.

Prisni një betejë të madhe detare

Nostradamus parashikoi në mënyrë specifike përshkallëzimin e konflikteve në oqean, pasi jo vetëm që do të godasin “përmytjet e mëdha”, por “frika” do të filtrojë nëpër oqeanet.

Kina do të përfshihet në konflikt

Për më tepër, Nostradamus parashikoi “betejë luftarake dhe detare” dhe tha se një “kundërshtar i kuq do të zbehet nga frika, duke e vënë në tmerr oqeanin e madh”.



Disa besojnë se “kundërshtari i kuq” mund t’i referohet Kinës.

“Beteja detare” mund t’i referohet tensioneve të Kinës me Tajvanin. Pekini aktualisht ka marinën më të madhe në botë.

Disa madje e kanë interpretuar këtë si një konfrontim të mundshëm midis Kinës dhe NATO-s, që do të sugjeronte agimin e një pakti të ri kinezo-rus.

Mund të ketë një papë të ri

Mbush 88 vjeç, më 17 dhjetor 2024, Papa Françesku ka pasur probleme shëndetësore së fundmi. Ai u ngjit në detyrën më të lartë të Vatikanit në vitin 2013 pas dorëheqjes së paraardhësit të tij.

Në vitin 2023, atij iu desh të anashkalonte Konferencën e OKB-së për Ndryshimet Klimatike, COP28, në Dubai për shkak të inflamacionit të mushkërive dhe problemeve të frymëmarrjes nga gripi.

Sipas parashikimeve të astrologut, Papa Françesku së shpejti mund të shohë një zëvendësues. “Përmes vdekjes së një Papati shumë të vjetër, do të zgjidhet një romak i moshës së mirë, për të do të thuhet se e dobëson shikimin e tij, por do të rrijë gjatë dhe në aktivitet thumbues”, ka shkruar ai. Rreshtat e shkruar parashikojnë vdekjen e Papës dhe zëvendësimin e tij nga një romak i ri. Megjithatë “Romake” është padyshim në lidhje me vetë Kishën në këtë rast.

Mbretërimi i mbretit Charles III do të jetë i shkurtër

Një parashikim i madh nga Nostradamus i referohet një “Mbreti të Ishujve” duke u “përzënë me forcë”. Megjithatë nuk ka asnjë referencë për ndonjë figurë të veçantë mbretërore, disa ekspertë besojnë se mund të jetë mbreti Charles. Pretendimi i Nostradamusit thotë: “Mbreti i Ishujve i dëbuar me forcë... i zëvendësuar nga ai që nuk do të ketë asnjë shenjë mbreti”.

Analisti dhe autori Mario Reading beson se Mbreti mund të japë dorëheqjen për shkak të “sulmeve të vazhdueshme ndaj tij dhe gruas së tij të dytë”. Megjithatë Princi William është pasuesi i radhës, disa analistë kanë pohuar se deklarata “pa shenjë mbreti” sugjeron që Princi Harry do të marrë fronin!



Kërcënimet kibernetike ndaj armëve bërthamore

“Sa më shumë të lidhemi online, aq më shumë duhet të shqetësohemi për sigurinë. Sa më shumë të varemi nga teknologjia, aq më shumë duhet të shqetësohemi për besueshmërinë e saj”, - Vint Cerf.

Çdo aspekt i shoqërisë është në rrezik nga sulmet kibernetike: rreziqe të bazuara, duke përfshirë sektorin financiar, industrinë e argëtimit, dyqanet e mallrave dhe organizatat e sigurimeve. Kur bëhet fjalë për sulmet kibernetike ndaj sistemeve të tyre më të rëndësishme, qeveritë përballen me një kërcënim edhe më serioz. Një sulm i suksesshëm kibernetik mbi një armë bërthamore ose një sistem të ngjashëm, si një armë bërthamore, një sistem shpërndarjeje ose sistemet shoqëruese të Komandës, Kontrollit dhe Komunikimeve Bërthamore (NC3), mund të ketë pasoja ekzistenciale.

Sulmet në infrastrukturën kryesore mund të kenë implikime ekstreme. Sulmet kibernetike mund të rezultojnë në paralajmërime të rreme për sulme, të prishin aksesin në informacion ose komunikime jetike, të minojnë shpërndarjen bërthamore ose sistemet e planifikimit, apo edhe të lënë një armik të marrë kontrollin e një arme bërthamore.

Rezistenca e sistemeve bërthamore mund të ndikohet negativisht nga përdorimi në rritje i teknologjisë dixhitale. Në sistemet historikisht elastike, si nëndetëset ose lëshuesit e lëvizshëm të raketave, teknologjia e re mund të përmirësojë performancën dhe besueshmërinë, por gjithashtu mund të krijojë dobësi të reja.

Megjithëse nuk ka pasur ndonjë sulm kibernetik të njohur publik mbi sistemet e armëve bërthamore, dukuritë e kaluara na japin një ide se çfarë mund të ndodhë. Për shembull, në vitin 1980, raketat u zbuluan se po shkonin drejt Shteteve të Bashkuara nga sistemet e paralajmërimit. Paralajmërimi doli të ishte një alarm i rremë i sjellë nga një çip kompjuteri me defekt në minutat para se presidentit t'i duhej të jepte një urdhër për hakmarrje.

Kohët e fundit, një mosfunksionim i sistemit kompjuterik shkaktoi rënien e 50 raketave bërthamore: të armatosura për rreth një orë. Këto raketa ishin me bazë në Wyoming. Këto janë llojet e dukurive që, veçanërisht në kohë krize ose konflikti, mund t'i shtyjnë liderët deri në pikën që të vendosin për të nisur një sulm bërthamor bazuar në inteligjencën jo të plotë dhe të dobësojnë besimin e tyre në sistemet ushtarake, gjë që është e nevojshme për të parandaluar një gabim serioz.

Faktori njerëzor është gjithashtu një shqetësim i rëndësishëm për sa i përket kërcënimeve kibernetike ndaj armëve bërthamore. Në vitin 2016, një studiues sigurie zbuloi se sistemi i raketave balistike ndërkontinentale Minuteman III përdorte një protokoll komunikimi të pasigurt që e bënte atë të prekshëm ndaj hakerave. Kjo dobësi u shkaktua nga një person i brendshëm, i cili qëllimisht futi protokollin e pasigurt në sistem.



Një tjetër kërcënim i mundshëm kibernetik ndaj armëve bërthamore është nëpërmjet sulmeve të zinxhirit të furnizimit, ku sulmuesit rrezikojnë sigurinë e një të treti: shitësi ose furnizuesi i palës që ofron komponentë kritikë ose softuer për sistemin e armëve bërthamore. Në vitin 2017, malware i njohur si ‘NotPetya’ ishte në gjendje të përhapej globalisht përmes sulmeve të zinxhirit të furnizimit, duke prekur disa kompani dhe duke shkaktuar miliarda dollarë dëme. Hakerët e Koresë së Veriut kanë qenë të lidhur me disa sulme kibernetikë: sulme ndaj objektivave bërthamore.

Në vitin 2014, një operator i centralit bërthamor të Koresë së Jugut u hakerua, duke rezultuar në rrjedhjen e planeve dhe informacioneve të tjera të ndjeshme. Në vitin 2017, një sulm kibernetik ndaj një kontraktori të mbrojtjes të Koresë së Jugut rezultoi në vjedhjen e informacionit të ndjeshëm ushtarak, duke

përfshirë planet për stërvitje të përbashkëta ushtarake me Shtetet e Bashkuara. Këto incidente demonstrojnë potencialin e kërcënimeve kibernetike për të dëmtuar fizikisht infrastrukturën kritike dhe nevojën për të mbajtur masa të fuqishme të sigurisë kibernetike dhe për të vlerësuar dhe adresuar rregullisht dobësitë e mundshme në sistemet e menaxhimit të armëve bërthamore.

Në vitin 2013, një raport nga Instituti Ndërkombëtar për Studime Strategjike (IISS) theksoi dobësitë në programin bërthamor të Pakistanit ndaj sulmeve kibernetike. Raporti theksonte se Pakistani kishte investuar relativisht pak në sigurinë kibernetike dhe ishte mbështetur në teknologjinë e vjetruar, duke i bërë objektet e tij bërthamore të cenueshme ndaj sulmeve kibernetike. Në vitin 2014, një grup hakerash që pretendonin se ishin nga India shkelën sistemet kompjuterike të Komisionit të Energjisë Atomike të Pakistanit (PAEC) dhe zbuluan informacione të ndjeshme.

Sulmi besohet të jetë pjesë e një fushate më të madhe spiunazhi kibernetik që synon agjencitë qeveritare indiane dhe pakistaneze. Në vitin 2015, FBI arrestoi një shtetas pakistanez në Shtetet e Bashkuara, i cili po përpiqej t'i shiste informacione të ndjeshme rreth programit bërthamor të Pakistanit të një agjent i fshehtë i FBI-së. Individit kishte punuar më parë si kontraktor në termocentralin bërthamor të Pakistanit në Chashma.

Këto incidente sugjerojnë se programi bërthamor i Pakistanit është i prekshëm nga kërcënimet kibernetike dhe nënvizojnë nevojën për masa të forta të sigurisë kibernetike. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se Pakistani ka një politikë të mbajtjes së një profili të ulët në programin e tij të armëve bërthamore dhe nuk zbulon publikisht detaje në lidhje me arsenalin e tij bërthamor ose masat e tij të sigurisë. Prandaj, shtrirja e kërcënimeve kibernetike ndaj programit të armëve bërthamore të Pakistanit mbetet kryesisht e panjohur.

Pasojat e një sulmi kibernetik të suksesshëm: Sulmi mund të jetë katastrofik, duke rezultuar në dëmtime fizike, humbje jetësh dhe potencialisht edhe luftë bërthamore. Do të nevojitet një përpjekje e bashkërenduar globale për të trajtuar rrezikun kibernetik të armëve bërthamore. Të gjithë kanë interes për të shmangur një sulm kibernetik që ose shkaktonte një lëshim ose shpërthim bërthamor ose që i paraprin, përkeqëson dhe intensifikon një katastrofë bërthamore. Prandaj, nevoja më urgjente është bashkimi i shteteve bërthamore të armatosura dhe kërkimi i konsensusit për parandalimin e dinamikave më të rrezikshme të ofruara nga kërcënimi i ri kibernetik.




Pandeli Bardhi, nga jeta e Shkollës Ushtarake "Skënderbej", në vitet 1962-1966

Vitet e fëmijërisë, mbahen mend e fiksohen në kujtesë për të mos u harruar për gjithë jetën... Kujtimet që shkruhen për vitet e Shkollës Ushtarake "Skënderbej", janë një kënaqësi e veçantë për secilin prej nesh, që ka kaluar në bankat e kësaj shkolle. Ishte viti 1962, kur akoma nuk ishin prishur marrëdhëniet me ish-Bashkimin Sovjetik... Bukuria e atyre viteve, nuk ishte tek uniforma ushtarake, por, mbi të gjitha tek rregulli e disiplina, kërkesa e llogarisë për të bërë gjithçka me rregullore, duke u ndarë njëherë e mirë nga jeta civile... Këtej e tutje, gjithçka do të bëhej me urdhër, me sinjal e me komandë, që nga zgjimi në mëngjes e deri në kontrollin e uniformës e pamjes së jashtme në kontrollin e mbrëmjes, që bëhej nga ora 21.30 deri në orën 22.00.

...Ishte 21 gushti i vitit 1962, kur u grumbulluam në Degën Ushtarake të Qytetit të Korçës. Lajmërimin e kishim marrë, në mos gaboj, jo më shumë se dhjetë ditë përpara...

..Erdhi dita e shumëpritur e 21 gushtit. Hipëm në një makinë "ZIS" sipër në karroceri. Ishin tre makina të tilla që u nisëm autokolonë nga qyteti i Korçës dhe mbas afro shtatë orë udhëtimi, arritëm në Tiranë rreth orës 18.00, të asaj dite. I pari që na mori në dorëzim, ishte Emini, përgjegjësi i lavanterisë ku do të bënim dush për të hequr rrobat e fshatit e për të veshur ato të "qeverisë"! Nuk ja mbaj mend mbiemrin Eminin, por mbaj mend që më vonë e thërrisnim Emin Garinça, sipas emrit të një futbollisti të njohur në atë kohë. Urdhri e parë e morëm nga Emini, i cili na u drejtua: "Do të hyni të laheni. Plaçkat që keni veshur do t'i mbështillni e do t'i lini mënjanë. Do të vishni ndërresat që do t'ju jap unë. Kur të dëgjoni çangën e parë, do të shkumoheni e më pas do të shpërlaheni. Kur të dëgjoni cangën e dytë do të shkumoheni përsëri dhe do të shpërlaheni dhe kur të dëgjoni cangën e tretë, me vrap do të fshihen, do vishni ndërresat dhe me vrap do të rreshtoheni. Nuk ka këtu nënë e baba. Këtu çdo gjë bëhet vetëm me cangë!". I zbatuam me përpikëri të tria çangat e Eminin megjithëse ishim të lodhur, por askush nuk na pyeste. Deri një ditë më parë, ne ishim mësuar të flinim, të hanim apo të bridhnim kur të donim, por tashmë... Emini, ishte i pari që njohëm në këtë shkollë dhe kur e njohëm më mirë më vonë, kur u bëmë "dautë" me Eminin, "eporin" e parë që njohëm, u bëmë shokë, sepse ishte njeri shumë i mirë. I veshëm ndërresat që na ndau një kapter, i cili na hidhte një shikim se çfarë numri përfaqësohej i donim mbathjet apo këmbës. Po kështu edhe pantallonat dhe gjimnastorkën, të modelit sovjetik, me pesë kopsa të verdha përpara, që ne e dimë se ç'kemi hequr për t'i mbajtur gjithnjë të shndritshme e sidomos kur dilnim liridallje... Po kështu edhe tokëzat e rripave edhe ato të kapotave në dimër, të cilat edhe mbrapa kishin një kollan që mbërthehej me dy kopsa. Në orët e vona të darkës, u rreshtuam në fjetinën ku do të flinim, të rreshtuar me uniformën e re, që nuk do të na hiqej kurrë. Rrobat që kishim me vete i dorëzuam për t'i marrë, siç na thanë, kur të shkonim me leje për vitin e Ri. Bashkë me rrobat, "dorëzuam" edhe "jetën" e fshatit apo të qytetit, edhe lodrat, edhe gjithçka tjetër për t'u futur në një jetë tjetër, në jetën ushtarake me rregullat e kërkesat e saj. Përpara se të rreshtoheshim në fjetinë, sipas emrave që na kishin ndarë në kompani dhe në toga, ku mua më qëllloi që të isha në Kompaninë e Dytë... Dëgjohej vetëm zëri i kapterit Selam Gaba, në mos gaboj, i cili na tregonte si vendoseshin pecet në këmbë, si qepej qaforja, si lustrheshin këpucët dhe ai që nuk do t'i bënte ato po atë natë ashtu si thoshte ai, nuk do të flinte gjumë.

...Ditën e katërt fizkulturën e mëngjesit e bëmë 5 km larg mbi Kinostudion "Shqipëria e Re", më shumë për të mësuar itinerarin e fizkulturës së mëngjesit, që përveç dy apo tre xhirove rreth stadiumit të shkollës në mëngjes, do të bënim edhe këtë itinerar, sidomos në orët e fizkulturës. Në kthim, duhej të merrnim secili disa degë shoqe për të pastruar territorin përpara fjetinave sipas ndarjes. Për 10 ditë rresht, deri në fillimin e mësimit, bëmë vetëm trenazhe, si të zgjoheshim me shpejtësi e të rreshtoheshim para krevatit, si të mbanim pajimet luftarake, që ato të ishin në gatishmëri në rast alarmi apo kushtrimi, që i thonë sot, duke bërë edhe ditë për ditë prova. Përpara fillimit të mësimit, na u shpërndanë edhe armatimi personal, që përbëhej nga arma (KVS Karabina vetëmbushëse



Simonov) kundërgazi, kompleti kimik (çorape, pelerinë, doreza) etj., dhe një orë në ditë do të mësonim si pastrohej arma, që në ditët në vazhdim do të ishte një gjysmë ore në ditë pavarësisht nëse arma dilte në stërvitje apo jo.

...Mbj mend që unë rrija me të ndjerin Bashkim Gjoza, i cili ishte në kompani tjetër dhe unë shkoja kastile për ta takuar... Mbj mend, në një ditë shtatori ulur në një stol, kur Bashkimi më tha: "Unë e kam fjetur mendjen, do të iki, ti, po deshe ik, po deshe qëndro. Por unë do të iki!". Edhe unë isha i gatshëm për të ikur dhe atë ditë rashë dakord për t'u larguar. Më vonë i thirra mendjes dhe i dhashë "garjet" vetes: Bashkimi, edhe mund të ikë, thashë, sepse ai ka të tjera kushte. Ai banon në qytet dhe atje ka shumë kërkesa për punë. Siç kishim biseduar, Bashkimi i vinte ndoresh për hidraulik, elektrikist, biçikletar etj., po unë i ziu, ku të mbytem përveçse në gjolin e Zagradecit? Po mirë, i thosha vetes, të largohem, po ku do të shkoj unë në një kohë që në fshat vetëm kazma më pret? Kështu thoshin në fshat atëherë. Një meritë të madhe për këtë ka edhe shoku im më i ngushtë i atyre viteve Lefter Leskaj nga Bolena e Vlorës, me të cilin qëndronim gjatë gjithë kohës bashkë dhe nuk ndaheshim. M'u kthye mendja dhe të nesërmen i thashë Bashkimit: "Do të mendohem edhe njëherë!". Një letër që më erdhi atë ditë nga babai ma ktheu mendjen e ma bëri "top" për të mos u larguar. Midis të tjerave, babai shkruante: "E dimë që je mërziur, sepse nuk është e lehtë të jesh larg shtëpisë. Por do të durosh, sepse fshati nuk lëviz, këtu është dhe po të vish, kazmën gati e ke!". Pas dy tre javësh, Bashkimi iku dhe unë u mërziu shumë. Qëndroja me dy shokë, njëri nga Strelca e Oparit, Vladimir Selimollari dhe tjetri nga Desmira, Fatmir Besholli. Kisha edhe një tjetër, Gëzim Xama

nga Piluri, por Gëzimi nuk ishte tip që shoqërohej dhe më shumë qëndronte i mbyllur në vetvete... Me Marko Gërden nga Vithkuqi shkonim shumë mirë. Ditët kalonin dhe filluam mësimet. Më në fund mund të qëndronim ulur disa orë në klasë, duke bërë mësim, paradite dhe pasdite, katër orë studim, nga ora 16.00 deri në orën 20.00 ishin te detyrueshme. Mësuam të gjitha të mirat që ishin të vlefshme, por mësuam edhe një ves të keq, atë të pirjes së duhanit. Kishim dy tre duhanxhinj në klasë dhe na dukej sikur hiqnim mërziun kur tymosnim. Nuk lejohej gjëkund pirja e duhanit, por ne, ia kishim gjetur "marifetin", duke e pirë në tualete! Mësuesit na prezantoheshin një nga një sipas lëndëve që kishin. E kujtoj me mall e më dalin lot, kur kujtoj të madhin Adriatik Kallulli, mësuesin e letërsisë.

Pas Adriatikut, ditën e parë të shkollës kishim lëndën e historisë me profesorin Irakli Kasneci. Ishte i moshuar dhe shumë i mbajtur, korrekt dhe me një kostum blu. Siç dëgjonim kishte patuar funksione të larta në Ministrinë e Arsimit në kohën e Mbretit Zog... E ç'mund të them unë për mësuesin e Fizikës, Viron Cinxon. Ishte një talent i rrallë dhe tepër kompetent në lëndën e vështirë të fizikës. Ndër të gjithë mësuesit, mësues Vironi, ishte "tmerri" jonë. Jo vetëm në klasë, por edhe në rrugë kur e takonim, instiktivisht merrnim qëndrim "Gatitu"! Ai, as nuk na shante, as nuk na bërtiste kurrë, por ja që ne na ishte fiksuar që e kishim "frikë"! Sapo hynte në klasë, të gjithë dridheshim dhe qëndronim në ankth se kush e ka radhën sot për të shkruar në "gijotinë" d.m.th. të ngrihej në mësim, që ç'është e vërteta, ishin mësimet shumë të vështira. Edhe në fizikë edhe në Astronomi që na jepte mësues Vironi për të kontrolluar dijet tona na thoshte "Nxirrni nga një fletë dhe laps. Provim me

JETA ËSHTË SHUMË E SHKURTËR. NË ATË KOHË, STËRVITESHIM, PUNONIM, E SAKRIFIKONIM, KISHIM NJË DASHURI TË JASHTËZAKONSHME ME NJËRI-TJETRIN. ISHIN KATËR VITE QË ISHIM BASHKË GJATË GJITHË DITËS E NATËS, QYSH NGA VEPRIMET E MËNGJESIT E DERI NË KONTROLLIN E MBRËMJES, NË ORËN 22.00. NË PËRFUNDIM TË KATËR VITEVE U NDAMË SIPAS SPECIALITETEVE NË SHKOLLËN E BASHKUAR, DHE MË PAS MBAS TITULLIMIT SI OFICERË U SHPËRNDAMË NËPËR REPARTE E NËNREPARTE, SIPAS LLOJEVE TË ARMËVE E SHËRBIMEVE.

shkrim!”. Vetë ikte dhe nuk kthehej më. Edhe pa prezencën e tij, ne dridheshim nga frika dhe nuk guxonim as të hapnim gojën e jo më të kopjonim apo të kërkonim ndonjë ndihmë të vogël nga shoku i bankës apo ndonjë shok tjetër... Të gjithë, një nga një i dorëzonim në tavolinën e mësuesit dhe largoheshim. “Sekretin” e kësaj metode profesor Vironi na e tha, më 26 maj të vitit 2016, kur e ftuam në 50-vjetorin e maturës (1966-2016).

Preofesori na tha: “Dëgjo tani. Unë e kisha shumë të qartë që juve bëheshit copë për të mësuar, të gjithë, me diferenca shumë të vogla, lëndën, dhe megjithse ishte shumë e vështirë, juve e kishit përvetësuar. Unë e dija gjithashtu që juve lëndën e fizikës e kishit marrë me frikë, siç ishte edhe matematika. Unë, me qëllim ju bëja ndonjë provim me shkrim dhe largohesha duke shkuar në kafe. Më thotë një oficer një ditë, shefi i stërvitjes së Shkollës, Skënder Bajraktari: “More Viron, nuk keni mësim?”, - ‘Kam i them, por i kam lënë të bëjnë provim me shkrim’. - Po mirë, keni besim që ata nuk kopjojnë”? Dhe i them: “Unë për këtë punë kam ikur, që ata të kopjojnë, por e di që të katër klasat që jap unë mësim, e di që nuk kopjojnë edhe sikur t’i lesh gjithë ditën vetëm!”. Kështu i thosha të gjithëve sa herë që më pyesnin... Matematikën na e jepnin dy mësues, Liri Poçi dhe më pas Vedat Cami. Që të dy, ishin të mrekullueshëm dhe shumë kompetente. Liri Poci, ishte shumë serioze dhe ne nuk mund të bënim asnjë muhabet përveç normave të lejuara për përvetësimin e lëndës. Ishte e gatshme të vinte nga shtëpia në orët e pasdites për konsultime dhe ne ishim të kënaqur. Sa e lumtur ishte kur ne pyesnim dhe deshëm të sqaronim çdo paqartësi. “Pyesni sa më shumë, - na thoshte, - sepse sa më shumë të pyesni, aq më shumë do të përvehtësoni mësimin!”. Kurse me mësues Vedatin, i cili ishte njeri i qetë dhe shumë i duruar, ndonjëherë bënim edhe ndonjë shaka të vogël dhe ai na lejonte të bisedonte me ne si shokë me gjithë frikën që kishim, sepse ishte lënda e tillë “serioze”, që nuk lejonte hapësira për interpretime si shkencë ekzakte. Mësimin e anglishtes, na e jepte Mahmut Toro. Ishte i moshuar dhe shumë korrekt. Edhe Filip Tola që e kishte hartuar vetë tekstin, ishte mësues në shkollë, por ne nuk na jepte mësim... Më pas Anglishten do ta bënim me mësues Afrim Karagjozin, por nuk i jepej rëndësia e duhur kësaj lënde... Mësimin e rusishtes, na e jepnin fillimisht Haki Lundra nga Dibra dhe më pas mësuese Hamide Daja. Ishin që të dy profesionistë dhe kompetentë. Lëndën e Kimisë, na e jepte Vera Veshi dhe mësimin në laborator, të shumtën e orëve i zhvillonim me nëndrejtoreshën e shkollës, Agime Çela. Përpara se të na jepte mësim Vera Veshi, na kishin dhënë mësim dy mësues të tjerë si Bujar Llagami dhe Llazar Mbreshtanaku nga Berati, të cilët qëndruan pak kohë dhe u larguan. Lëndën e gjeografisë, na e jepte Tefta Xholi. Lëndën e Botanikës, na e jepte Arsino Gëdeshi, atë të Historisë, në fillim Marije Nano dhe më pas Sami Bogdani. Të gjithë ishin të aftë dhe profesionistë. Për pak kohë, mësimin e historisë na e jepte Timo Shkurti. Nuk na jepte mësim, por nuk mund të lë pa përmendur drejtorin e shkollës Stavri Angjeli, një burrë babaxhan dhe i nderuar, një “shpirt njeriu”, siç i thoshin.

...Disa shokë ishin larguar nga shkolla me dëshirën e tyre dhe shumë të tjerë u larguan si masë ndëshkimore për thyerje të disiplinës. Mbas më shumë se dy muaj qëndrimi nga fundi i muajit tetor për të parën herë do të dilnim liridalje në qytet, sipas një rregulli të vendosur një herë në dy javë... Në ditën e liridaljes, që zakonisht ishte ditë e diel apo ditë feste, ngriheshim që herët dhe do t’i kryenim të gjitha detyrat me përpikëri që nga rregullimi i krevateve, pastrimi i fjetinës dhe i tualeteve dhe më pas rregullimi personal i uniformës, si qepja perfekte e qafores, lustrimi i këpucëve dhe hekurosja e pantallonave. Për hekur hekurosje nuk bëhej fjalë, por qysh në darkë, pantallonat duhej t’i vendosnim midis dy batanijeve të leshit dhe gjithë natën mundoheshim të flinim, duke mos lëvizur shumë, sepse pantallonat do të rrudhoseshin, nuk do të merrnin hekur dhe do të na “digjej” liridalja. Kohën më të madhe e harxhonim duke pastruar kopsat e gjimnastorkës që ishin ngjyrë e verdhë dhe duhej të shkëlqenin, duke u pastruar me sidol. Nuk ishte e lehtë të gjeje sidol dhe në shumë raste i pastronim me kolinoz, një “eksperiencë” kjo, që e kishim marrë nga sovjetikët. Ishte sistemi i gradave dhe kopsat ishin të shumta përpara, në supe, përpara kapotës, mbrapa kapotës etj. Më të lehtësuar ishim kur kopjuam modelin kinez në uniformë, sepse nuk kishte shumë kopsa dhe ato që ishin nuk kishin nevojë për pastrim. Sa herë që na jepej urdhër për të zbërthyer dy kopsat e para ishte për ne një “fitore” e madhe sidomos në ditët e verës. Vërejtja “Pse zbërthyer” na delte edhe në ëndërr! Bënim disa prova se si të nderonim eprorët në qytet me hap reshtor katër pesë metra para se të afroheshim. Si për inat, disa oficerë madhorë dilnin me gratë që ato të shihnin se si nderoheshin burrat e tyre. Ne, ruanim sa të

afroheshim disa metra tek eprori që shëtiste dhe fillonim nderimin me hap rreshtor. Sa u bëhej qejfi. Por nuk ishte e thënë që të gjitha të shkonin vaj. Nuk e pamë një ditë një epror, nuk e nderuam dhe ai na thirri. “Pse nuk nderoni!”. U munduam të justifikohemi por ishte e kotë. “Keni edhe llafe shumë, llafazanë!”, na bërtiti. Thirri patrullën e garnizonit, të cilët na çuan drejt e në dhomat e izolimit të garnizonit të Tiranës, aty ku ishte hotel “Drini”. Tërë natën e kaluam me një pjatë supë sorugato dhe në dyshekë me kashtë. derisa erdhi na mori komandanti i kompanisë, siç ishte rregulli. Çdo natë, para se të flinim do të bëhej kontrolli i mbrëmjes, ku do të na kontrollonin llustimin e këpucëve, qaforet si ishin qepur, kopsat i ishin pastruar tokëzat e rripit të mesit, ishte pastruar apo jo etj. ... Kujtoj alarmet që bëheshin nën tingujt e burisë në ditët e acarta të muajit janar. Itinerari ishte i përcaktuar. Në drejtim të Malit të Dajtit, por jo në rrugën kryesore, mëngjesi tek kampi i punëtorëve, në Qaf Shtamë, në Malin me Gropa, e rreth e qark malit të Dajtit, në Malin e Sari Salltikut, qyteti i Krujës, Fushë-Krujë, Rinas e kthim. Në raste të tjera e fillonim marshimin në drejtim të Shkallës së Tujanit, rreth malit të “Skënderbeut”, Mamurras, e kthim. Në këto marshime tre ditore, njërën natë do ta kalonim në shtëpitë e banorëve, si në Mamurras dhe qytetin e Krujës, ndërsa natën e dytë do të ngrinim çadrat që kishim me vete. Kujtoj mëngjesin, kur Sherif Çiciku, shoferi i makinës ZIS, na sillte fasulet e ngrohta në kampin e Punëtorëve. Ato ishin të ngrohta deri sa shtiheshin në gavetë, por në gojë do të shkonin akull, të cilat kërcisnin në dhëmbë. Megjithatë, ne na dukeshin mjalhtë. Edhe të ftohtin e madh, edhe vapën përvëluese të korrikut i përballonim me sukses. Ishte mosha atëherë. Të gjithë për një qëllim të vetëm, të gjithë për të njëjtin ideal... Kujtoj eprorët e mi të mrekullueshëm, mësuesit e artit ushtarak. Shahin Leka, Muhamet Ormëni, Muhamet Hoxha, Rexh Ndreu, Zoi Toska, Pajtim Çela, Jorgji Cami etj. Kujtoj ditët e nxehta të verës 1964, kur mbas mësimit do të shkonim në rresht në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, për të bërë përgatitje për parakalimin e madh në kuadrin e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Ditë të mbushura me aktivitete, me lodhje, me sakrifica. Sa më shumë afrohej dita e 29 Nëntorit, aq më shumë shtoheshin orët e përgatitjes për parakalimin në ditën e festës. Në darkë, bënim prova ceremoniale siç do ta bënim parakalimin në ditën e 29 Nëntorit. E megjithatë, mundimi dhe sakrificat nuk shkuan kot. Parada u bë madhështore, ashtu si ishte parashikuar me pjesëmarrjen e të gjithë efektivave dhe llojet e armëve. U harruan të gjitha kur Shkolla “Skënderbej” u vlerësua në vëndin e parë, duke merituar flamurin. Një tjetër fakt që na gëzonte ishte edhe uniforma e re me xhaketa të hapura dhe me kollare, me këpucë çeke me thumba metalike nga poshtë, për t’u dëgjuar mbi pllakat e bulevardit. Ushqimin e kishim shumë të mirë, por me thënë të drejtën, edhe nuk ngopeshim për vetë moshën dhe ngarkesën që kishim në stërvitje. Këtë “mungesë” kur kishim ndonjë “dhjetçe” në xhep, e kompensonim në pushimin e madh, që bëhej nga ora 09.30 deri në 10.00. Gjysmë ore kohë, ishte e mjaftueshme që të merrnim një kulaç gjashtëlekësh dhe një hallvë katërlekëshe që çdo mëngjes i sillte një makinë e vogël, që sapo e shihnim që hynte në oborrin e Shkollës, thoshim: “Erdhi gjeneral petulla!”. Neçua ishte shitës, në lokalin e të cilit kishte vetëm petulla, kulacë, gurabije dhe hallva. Edhe po të kishte më shumë, ne nuk kishim mundësi të blinim, sepse aq ishin të ardhurat tona. Jo përditë, por një ose dy herë në javë, merrnim ose kulaçë e hallva, ose nga një petull shtatëlekshe. Nuk mund të “nxjerr” jashtë kujtesës, kuzhinierin e Shkollës, Qirjakon, një njeri i dashur e i “ëmbël” si vetë ushqimi që gatuate dhe që ne e hanim me shumë shije. Jo vetëm në ditët e javës, por sidomos ditëve të diela, kur nuk dihej me saktësi se sa ishte numri i atyre që do të hanin drekë, sepse në ditët e liridaljes ata që ishin në Tiranë apo edhe të tjerë nuk vinin. Qirjako do të mbante dy ose tre tenxhere me pilaf apo ëmbëlsira rezervë, për t’ua dhënë atyre që ishin më tepër nga sa ishte parashikuar për të gatuar. Qirjako, mendonte që askush të mos mbetej pa ushqim. Do të kujtoj fjalët e tij në një ditë të diele në drekë tek sporteli ku unë dhe disa të tjerë shkuam për të kërkuar diçka për të ngrënë, sepse erdhëm me vonesë. “Ka hxaxhai për juve. Juve jeni të vegjël dhe nuk keni pranë as nënën as babanë që të kujdesen. Për kohën që jeni këtu, do të kujdesemi ne që juve ta ndjeni veten sikur të jeni me prindërit tuaj!”. Dhe Qirjako, na bëri që të dalim më të “fituar” nga ata që ishin të rregullt dhe që kishin ardhur në orarin e caktuar.

Tek shkruaj këto kujtime, më ngacmojnë kujtesën të kujtoj shokët e klasës, të kujtoj të gjithë shokët që kam njohur gjatë atyre katër viteve. Jeta është shumë e shkurtër. Në atë kohë, stërviteshim, punonim, e sakrifikonim, kishim një dashuri të jashtëzakonshme me njëri-tjetrin. Ishin katër vite që ishim bashkë gjatë gjithë ditës

e natës, qysh nga veprimet e mëngjesit e deri në kontrollin e mbrëmjes, në orën 22.00. Në përfundim të katër viteve u ndamë sipas specialiteteve në Shkollën e Bashkuar, dhe më pas mbas titullimit si oficerë u shpërndamë nëpër Reparte e nënreparte, sipas llojeve të armëve e shërbimeve. Rrallë takoheshim me ata që kishim në klasë apo me ata që ishim në të njëjtin vit shërbimi. I kujtoj edhe sot shokët, qysh nga Luci Gjino nga Semani i Fierit që e kisha shok banke e deri tek Servet Haxhiraj nga Vlora, që ishte në fund të radhës së tretë të bankave. Atëherë nuk e mendonim që vitet do të iknin shumë shpejt dhe shumë nga shokët tanë, janë ndarë nga jeta. Me iniciativën edhe të shokut tim të klasës Mit’hat Çekrezi, menduam që të bëjmë një takim në kuadrin e 50-vjetorit të përfundimit të maturës, në vitin 1966, plot pesëdhjetë vite më parë. Takimi u bë më 26 maj të vitit 2016... “Të vijnë ata që kanë mundësi të vijnë”, menduam. Nuk u mblodhën më shumë se dymbëdhjetë vetë Siç edhe na ishte fiksuar qysh atëherë, që në çdo mbledhje apo takim të kontrollojmë pjesëmarrjen e të evidentojmë mungesat, i “shoshitëm” dhe i kujtuam të gjithë një për një. Kujtuam Pullumb Shaqirin, futbollistin e shquar të “Partizanit”, kujtuam Vasil Deçkën, “majucin” shkodran, portierin e “Dinamos” në mos gaboj, por që tashmë, nuk është në jetë. Nga toga (klasa) jonë dolën shumë kuadro me detyra të rëndësishme, siç është Ylli Dimraj, i cili mori edhe gradën e “gjeneralit” si Komandant i Forcave Ajrore etj. Nga klasa jonë, nuk ishin të paktë ata që u larguan nga shkolla për arsye të ndryshme si Adil Hysa nga Elbasani, Thoma Pali e Spartak Mitko nga Korça, Fatmir Lloji, Skënder Çipi etj...

...Në takimin e dekadave më pas, ajo ç’ka na trishtoi të gjithëve, ishte që shumë nga shokët tanë, janë ndarë nga jeta. Në takim, mungon Bashkim Shori nga Berati, i cili u nda nga jeta muajin që do të merrte pensionin e parë. Bashkimi, esmer nga ngjyra, aq i zgjuar e i urtë, aq shumë i apasionuar pas lëndës së letërsisë, të cilin Profesor Adriatiku, e deshi shumë. Në takim “mungon” Enver Osmani, zëvendës komandanti i togës (klasës), i cili para fillimit të orës së ç’do lënde, i paraqiste forcën mësuesit të lëndës. Mungon edhe Perlat Shabani, i cili është ndarë nga jeta në vitin 2011; mungon edhe Servet Haxhiraj aq i apasionuar pas Flotës Luftarake Detare, ku arriti në instanca të larta në njësitë e kësaj Flote në Ishullin e Sazanit; mungon dhe Lenin Pumo nga qyteti i Fierit, aq i dashur me shokët aq i kudogjendur për të gjithë, që asnjëherë dhe me askënd nuk e prishi qejfin! Mungon edhe Premto Puleri, një kollos djalë nga minoriteti i Gjirokastrës, të cilit, nuk i u dëgjua njëherë zëri. Premtua ishte modeli i shokut të dashur e të urtë, e shokut të palodhur në punë e shokut që një pjesë të kohës së tij e harxhonte duke ndihmuar shokët. Mungon edhe Maksut Xhafa, nga fshati Burizanë i Krujës, një njeri me vullnet të hekurt për të mësuar. Për arsye të ndryshme nuk mundën të vijnë as Genc Domi, Zija Balla, Gëzim Çela, Zyhdi Turja, Torez Cëraku etj. Bashkë me ne, janë edhe pedagogët tanë të mrekullueshëm Viron Cinxo dhe Vedat Cami, pedagogët e dy lëndëve më të vështira, fizikës dhe matematikës... U çmallëm atë ditë me shokët e mrekulluehëm, Mit’hat Çekrezi, Kujtim Resuli, Maksim Mema, Teki Koka, Namik Gjonedaj, Bardhyl Sulaj etj...

Ato vite jo vetëm nuk harrohen kurrë, por janë edhe të madhërishëm. Madhështia e tyre, qëndron në atë që ne, katërmbëdhjetë-pesëmbëdhjetë vjecarët, në atë kohë, ishim si një “letër e bardhë”. Mbi këtë “letër të bardhë” “shkroi” vetëm ligji, “shkruan” vetëm kërkesa e rregullores. Të parat ç’ka mësuam ishin rregulli e disiplina, korrektësia, dashuria për shokët e mbi të gjitha u rrënjosën normat e moralit njerëzor. Ishin adoleshentë atëherë dhe me dëshirë apo me imponim, na u rrënjosën qysh atëherë ndjenja e kolektivitetit, dashuria për njëri-tjetrin ndihma për njëri-tjetrin. Të gjithë duheshim sikur të ishim pjesëtarë të së njëjtës familje, cilësi këto që jo vetëm i kemi ngulitur në kujtëse, por edhe i kemi propaganduar tek të tjerët gjatë gjithë viteve të ushtrisë. Është kjo arsyeja që jo vetëm brezi ynë i oficerëve, por edhe ata para e pas nesh, janë dhe mbeten model i njerëzve të respektuar në familje, në shoqëri e kudo. Është kjo arsyeja që ne, brezi i të moshuarve, jo vetëm oficerë, por të të gjitha profesioneve ndiejmë keqardhje me brezin e sotëm të të rinjve e të rejave, ndonëse jo të gjithë me respektin që tregojnë ndaj prindërve, me mënyrën e komunikimit e sjelljes në shoqëri. Nuk na vjen mirë dhe indinjohemi kur të rinj e të reja kanë dalë nga “shinat” e moralit të shoqërisë demokratike, duke ecur edhe vetë pa e ditur se ku. Ne i qëndruam besnikë një ideali, një bindjeje të caktuar, një qëllimi të madh për të cilin shërbyem me vite të tëra e jetuam me nder e dinjitet. Ato vite, për ne, brezin tonë, do të mbeten të shenjta, sepse morëm mësimet e para se si të bëhemi të vlefshëm për familjen, për shoqërinë e për Atdheun.

